



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/

Datë: 23.09.2019

24.09.2019
02/550

PROCESVERBAL

i mbledhjes së VIII-të (tetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e IV-2019.
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Komunën e Malishevës për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr:01/954 datë: 04.07.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, lidhur me kërkesën nr. 2683 dt:01.07.2019 e parashtruar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kullës së Sef Mleqanit në fshatin Mleqan KK. Malishevë.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr:04/125 datë: 10.07.2019, për rritjen e buxhetit të hyrave vetanake për vitin 2018.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr:04/126 datë:10.07.2019, për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019.
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2019.
7. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Shëndetësi për vitin 2019.
8. Shqyrtimi i vendimit lidhur me pagesën për nënat për çdo fëmijë të lindur.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/1597 datë:06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc, KK. Malishevë
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/976 datë:10.07.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shqyrtim dhe shfuqizim të vendimit nr.02/399 datë:04.07.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtim të Pishinës gjysme Olimpikë në Komunën e Malishevës.
11. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 18.07.2019 dhe filloi në ora 10:00. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 16 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, LMT, KKZ dhe media.

Rrahim Morina: Përshëndetje kuorum kemi prej 31 prezent janë 16, mue leje me kanë marrur vetëm 4 këshilltar kanë informacion për katër. Po fillojma me mbledhje kuorum kemi hapim mbledhjen e 8 të rregullt të kuvendit të komunës së Malishevës, materialin e keni marrur e kemi shpërnda me kohë kështu që ju përshëndes të gjithë të pranishmëve përfaqësuesit e Kforit një pjesë të qeverisë komunale anëtar të kuvendit hapi edhe mbledhjen e tetë të rregullt të komunës së Malishevës rendin e ditës e keni

marrur fillojna me piken jashtë të rendit të ditës edhe këtë herë po shkojmë kështu herën tjetër kush donë i dorëzon me shkrim, këtë mbledhje dhe mbledhjen tjetër i merë përgjigjet nga qeveria komunale me shkrim sot po fillojna kështu në këtë formë sepse po na merr kohë shumë. Sot po vazhdojna me pikën jashtë rendit të ditës a e donë dikush tjetër fjalën, urdhëro Alban Krasniqi pastaj Syll Dukolli.

Alban Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë fillimisht ju kisha dëshirë mirëseardhje të gjithë bashkatdhetarëve të cilët kanë filluar të vinë në vendlindjet e tyre ku dhe janë lind dhe janë rrit por fatkeqësisht një pjesë e tyre nuk jetojnë për shkak të rrethanave të tyre socioekonomike që kanë bërë që të dalin jashtë vendit. Nuk e di a po dëgjohet apo jo por me rëndësi në këtë dëgjohemi mes veti dhe uroj që në këtë vend puna të kryhet ashtu si është në përshkrim për mos mu marr me këso gabimesh ma shumë se sa mu marrë me punën që e kryen me planifikim në mënyrën që kjo lloj kulture i parandalon shumë sene dhe këto kablllo këtu që janë edhe parandalon këtë organizim kështu. Që sa kohë jemi duke e ngritur çështjen organizimit në hapësirat e kuvendit këtu edhe nuk ka as një veprim konkret në këtë rast edhe ju kryesues e keni përgjegjësin që anëtarëve të kuvendit të ju ofrohen kushte bazike për me ushtruar funksionin e tyre. Asambleistat nuk janë ca njerëz që kanë pikë prej qiellit këtu edhe një herë në mujt vinë takohen edhe flasin diçka edhe hecin realisht nuk përjashtoj raste të tilla që dikush edhe mund të jetë kështu por mendoj që shumica megjithatë janë të angazhuar edhe gjatë kohës kur nuk janë në kuvend edhe i kryejnë detyrat nuk ka as një mbështetje minimale prej komunës në këtë rast në sigurimin e kushteve për të mujtë dhe nuk ka as një bashkëpunim prej qeverisjes në ofrimin e informatave për mënyrën se si ofrohen shërbimet e lere ma kur ti bëhen kritikët edhe pastaj e jep një propozim dhe të merret për bazë dhe të trajtohet tujë fillu prej dhe menoj që përmi dhjetë herë e kemi trajtu dhe menoj që një drejtor në një qeverisje normale mu pas kanë dikund tjetër ish dashtë me shku në përgjegjësi dhe me shku në shtëpi drejtori. Prita shumë për diçka që nuk duhet të presë se detyrat dhe përgjegjësit duhet ti kryejnë. Në ti marrin secili detyrat dhe punët specifike që kanë qenë për kuvend dhe kjo mos të bahet. Këto kablllo nuk bën mu dok kjo tregon fukarallëk në mendje. Tash jemi në kohën kur një numër i bashkatdhetarëve fillojnë të vinë dhe uroj të kalojnë sa ma mirë edhe të muajnë mi krye edhe ato pune të karakterit administrativ të cilat komuna mund të ju afrojnë shërbime. Lëvizja vetëvendosje duke e parë këtë fenomen që po përsëritet çdo verë dhe komuna e Malishevës e merr një pamje tërësisht të ndryshme ku rritet numri i njerëzve dhe një qeverisje çka bën planifikon dhe detyrë e një qeverisje është që atë ta parashikoj sidomos kur ka një trend të përsëritjeve. Fatkeqësisht deri më tani në komunën e Malishevës nuk vërehet as një interesim për të ju ofruar institucioneve relevante në këtë rast për të ofruar shërbime ju lehtësojnë jetën qytetarëve dhe i mundësojnë ti kryejnë punët me kohë dhe mos të jenë peng i pushimeve por ti kryejnë me kohë dokumentet. Po ju hy me radhë 12 pika që në i kemi parë si masa që komuna duhet të ndërmerre.

Ato janë:

1. Të ofroj shërbime komunale dhe administrative me orar shtesë,
2. Furnizim maksimal dhe cilësor me ujë të pijshëm,
3. Mbledhja e rregullt e mbeturina.
4. Pastrimi i hapësirave publike ku komuna duhet të ketë një bashkëpunim më të mirë me EKO- Regjionin.
5. Mbarëvajtje dhe siguri në trafik një vërejtje shkon edhe për policinë e Kosovës ku nuk e di a keni parë një polic duke e rregulluar komunikacionin në këmbë një kund por jo nuk ka.
6. Hapësira të mjaftueshme për parking të makinave.

7. Hapësirë informuese 24 orë për qytetarët sepse bashkatdhetarët vinë dhe nuk kanë informacion për ndonjë shërbim.
8. Kontrollat e shtuara hidrosanitare dhe ushqimore me vjen mirë që është këtu edhe drejtori i inspektoratit unë e di që një pjesë të përgjegjësive e ka edhe ministria por një pjesë e kanë edhe kta.
9. Rritja ndaj kujdesit për rriqrat në kohën e bashkatdhetarëve.
10. Rritja e kapacitetit zjarrfikës
11. Shërbime mjekësore me kapacitet të shtuar
12. Aktivitete sportive për të gjitha moshat.

Sylë Dukolli: Përshëndetje kryetar kryesues për të gjithë të pranishëm përfaqësues të kforit dhe ju që e monitoroni pjesë e IT-së besoj që herëve tjera do ta kemi ma në rregull. Përshëndetje edhe për drejtorët që janë prezent këtu. Unë kisha ngrit një dy çështje, së pari i përshëndes të gjithë ata mërgimtarët që kanë ardhë uroj ta kalojnë sa ma mirë në vendlindjen e tyre dhe uroj rrugë të mbarë deri në vendlindje ata që vinë. Shumicën që tha asamblisti i VV besoj që janë të marrur ata hapa që ata të kalojnë sa ma mirë. Mirë edhe për parkingun e komunës të bisedohet në këtë fazë edhe për parkingun e veteranëve të UÇK-së edhe për atë periudhë ti ndahet një kompensim nga komuna që ata të kenë qasje për rregullimin e dokumentacioneve rreth komunës. Jam për orar të zgjatur pasi që një pjesë në administratë punojnë në kontratë ,mbi vepër dhe ta japin një aktivitet punues si ndihmës të atyre që bëjnë punë të vlefshme për mërgimtarët. Jam që në këtë kohë të gjitha ato që janë emergjencat ato tjerat të funksionojnë më së miri për shkak se rritet numri i atyre që kërkojnë në këto temperatura edhe ndihmë mjekësore edhe normal që rritet edhe sasia e mbeturinave dhe Ekoregjioni të rrit aktivitetin e vetë nëpër fshatra. Në fshatin tim ka fillu ndriçimi e përshëndes është mirë shumë që po ndodh ky projekt por unë e kam një vërejtje në aspektin që sipas projektit të shkon në rrugën kryesore në drejtim të Malishevës prej inës që i thojmë na e deri te shpia e fundit e fshatit kështu ka qenë projekti kështu është votu pse kanë ndodhë atje në fshat janë qitur dritat është shumë gjë e mirë edhe e nevojshme sepse edhe popullata është më e grumbullime por dua të marr përgjigje prej menagjerit se pse e ka bërë këtë unë dëgjova se në tension të lartë nuk qiten por unë pashë që edhe aty janë vendosur dritat d.m.th nëse është bërë ky projekt në të jetë aneks kurse në anën tjetër në të vazhdoi projekti që është votu këtu në asamble. Në komisioni të cilin e udhëheq Ali Morina edhe unë po marr pjesë dhe po kërkoj që të kemi kushte edhe aty sepse po punohet 4-5 orë.

Ilaz Krasniqi: Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë unë së pari dje isha te kryetari dhe kemi biseduar rreth lokacioni për 5 ari dhe aj me ka premtu që sot do të jetë këtu ajo kërkesë por nuk paska ardhë. Sa i përket ujit të pijes unë i kam disa analiza që janë bërë më: 17/06/2016 te tri lokacione: te xhamia në Banjë, shkolla e mesme Hamdi Berisha, dhe shkolla Habib Berisha Gurbardh këto analiza kanë dalur shume shqetësuese këto analiza janë bërë nga ingjinier dhe kimist të ujit dhe kjo delë shumë shqetësuese sepse nuk përmban klor sipas rezultateve nuk kanë bere klor dhe niveli i baktereve është shumë i lartë nuk duhet të jetë vetëm sasia por edhe cilësia sepse njerëzit edhe prej ujit shumë letë infektohen. Nuk e di se çka është ajo shishe barë oriental se a është e lejuar dhe i ki nëpër hyrje sigurisht shish bar drejtori i inspektoratit e din se çka është ajo por unë e di që nuk është najë aktivitet ose pozitivitet për mu. Në duhet që rinin ta orientojna ka është më mirë e jo të ju reklamojnë të gjitha të këqijat.

Leonitë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë unë kam një pyetje lidhur me ndriçimin rrugor se cilat rrugë kanë qenë në projekt të ndriçohen në fshatin Turjakë në fakt kamë edhe një shqetësim sepse në rrugën Ibrahim Rugova është vu vetëm një dritë ndriçuese edhe pse ka ndodh kjo.

Hidajete Mazreku: Përshëndetje të gjithëve unë deshta të ngriti një çështje që ka qenë e ngritue edhe më përpara dhe kam insistuar që mos me ardhur deri këtu fjala është për kanalizimin nga Lladroci mirëpo ura që është krijuar tek ne, tek rruga Brezovica unë edhe atëherë ju kamë tërheqë vërejtjen mos na lejoni që aty të bëhet të grumbullohet kanalizimi i të gjitha fshatrave sepse është mbet 200 ose 300 metra pa u definua kanalizimi që duhet të kyçet tek stacioni i autobusëve. Edhe ajo ura që është ndërtua ndoket në mars kur ka pasur vërshime i ka rreziku banorët aty sepse nuk i ka pasur mbrojtëset anash vetëm një kerr mundet me kalu aty ndërsa rrezikohen banorët. Unë e kam ngritë sepse kur te vjen vera nuk mundet me nejt kërkush aty prej erës. Banorët e lagjes janë të interesuar me krye aty lumin dhe kanalizimin dhe te kyçen aty lagjet që janë.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë unë deshta me ngritë çështjen e pagave të mësimdhënësve me bë një pyetje edhe drejtorit të financave se çato mjete që i kemi nda ku kanë mbetur sepse pagat jubilarë nuk i kanë marrur as një herë. Një kërkesë tjetër të çështja e drejtorit të shkollës Ibrahim Mazreku aj me datën 7 qershor ka dalë në pension dhe ende nuk është shpallur konkursi për atë shkollë. Është mirë me shpallë konkursin për atë shkollë dhe për shtator me fillu mësimi në atë shkollë. Një kërkesë e kamë për ty Kryesues nëse është e mundur që në seancën tjetër me najë sjellë të gjitha vendimet që i kemi marrur në si asamblistë kryesues edhe të gjitha interpretimet ligjore që i ka marrur ministria qendrore në Prishtinë. Nënkyetar ndriçimi publik në pjesën Ibrahim Mazreku nuk është në funksion, është mirë me i rregullu dhe me nda mjete financiare për rregullimin e tyre pasi edhe është pjesa kryesore e qytetit. Te vendosja e ndriçimit publik në fshatin Shkozë kryetari u arsyetu që nuk i kemi vendosur disa drita sepse aty shtyllat nuk janë të mira ndërsa nëse shkon në fshatin Maxharrë shtyllat janë edhe më të dëmtuara dhe janë vendosur dritat për ndriçim publik. Te çështja e klimave kam qenë unë aj që kam intervenu për mi rregullu klimat në kuvendin komunal se përndryshe as sot nuk kishin funksionu. Edhe te çështja e ujësjellësit me rregullue sepse ka familje që janë të kyçura në ujësjellës e nuk janë të kyçura në kanalizim por e paguajnë edhe kanalizimin me rregullu diqysh këtë punë.

Ali Morina: Përshëndetje për ju të pranishëm. Deshta me ngritë një shqetësim kryesues me datë: 19.11.2018 në ju kam drejtu drejtorisë së Shërbimeve Publike konkretisht drejtorit Milazim Morina për vendosjen e disa pengesave në rrugë, ndërsa unë nuk kamë marrur ende përgjigje prej tyre kam qenë në kontakt me ta përgjigja e tyre gojarisht është se na nuk kemi qasje në atë rrugë sepse është rrugë regjionale. Kërkesa ime është që ne ti drejtohen institucionit përkatës dhe ne të bahet kjo zgjidhje pasi që veturat që kalojnë në atë rrugë janë me shpejtësi shumë të madhe. Një shqetësim tjetër kryesues është edhe një pyetje për drejtoreshën e kulturës, Festivali Oda e Llapushës është një Festival tradicional ndërsa në faqe të komunës është parapa që me 1 (një) dhe 2 (dy) Gusht në ora 7 (shtatë) nëse e lexon pak ma nelt parakalimi i rapsodëve dhe grupeve që vinë me përformu në atë festival do të filloj në ora 6 (gjashtë) duke fillu prej rrugës Hamdi Berisha atje te KEKU me vazhdu teposhtë. Deshta me ditë drejtoreshë, a është parapa edhe aj aktivitet dhe nëse po pse qytetarët nuk janë njoftu që fillon në ora 6 (gjashtë) aj aktivitet dhe aty shkruan që aktiviteti fillon në ora 7 (shtatë) edhe ka karakter

garues, cili është shpërblimi që e fiton garën dhe ana tjetër kush është përbërja e jurisë në atë festival që do ta precizoj se kush është fituesi?

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë, për pagat e mësimdhënësve dhe të gjithë atyre që ju takojnë në bazë të ligjit dhe që janë nënshkruar pa bazë buxhetore. Kur është nxjerr vendimi në kuvend unë e kam dërgu shkresën me Ministri të Financave dhe fletëtransferin që ato mjete mu transferu në mallra dhe shërbime e kam komplet dosjen që e kam dërgu atje. Dy herë e kam përcjellë shkresën e parë me 30. 07. dhe shkresën e dytë e kam përcjellë me të 05.10 ku ata ma kanë kthyer një përgjigje përmes melës zyrtare që nuk lejohet shpenzimi për pagesat e punonjësve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në bazë të nenit 12 pika e 4 e ligjit të buxhetit dhe për këtë arsye ne nuk kemi mundësi nga ai projekt kapital mi transferu mjetet në kategorinë mallra dhe shërbime për me mujtë mi ekzekutu ato pagesa. Nëse kërkesa jon do të ishte nga kategoria Paga dhe mëditje për me pas mundësi për mi ekzekutu pagesat atëherë kjo do të ishte e pa mundur se të pensionuarit vetëm kanë dale prej sistemit të pagesave dhe nuk ka pas mundësi mi fut ata parapa në sistem të pagesave për me mujtë mi ekzekutu këto paga përcjellëse.

Besa Kryeziu – Ramaj: Përshëndetje për juve të gjithëve jemi në kuadër të aktiviteteve duke i realizuar për nder të bashkatdhetarëve po ju përsëris edhe aktivitetet të cilat do ti merr Komuna e Malishevës: Festivali Folklorik Oda e Llapushës i cili realizohet për herë të gjashtë që do të mbahet me datën 1 (një) dhe 2 (dy) gushtë, përveç kësaj është edhe promovimi i librit i cili është: Folklori në Trevën e Llapushës, kemi Panairin Artizanal etj. Isha ndalur ja kishna dhanë një përgjigje Aliut që tha për orën por është hera e gjashtë Festivali gjithmonë është shkuar në këtë mënyrë për shkak të numrit të madhë të pjesëmarrësve të ansambleve është bërë Defileu që nuk e kemi bërë publike mirpo, se as promovimi i librit nuk është bërë publike do të jetë promovimi i librit nëpër ftesa. Mirpo tek Defileo këtë të gjithë e din mirpo nuk po di se si nuk paska ardhur ky informacion tek ju. Tek juria Këshilli Organizativ është ai që vendos për jurinë profesionale, mirpo emrat nuk po i potencoj dy i keni të sigurt sepse lidhen me festivalin e vitit të kaluar sepse kemi pasur edhe simpozium për nder të folklorit. Është edhe profesor-dr. Zymer Neziri dhe profesor- dr. Adem Zejnullahu ndërsa të tretin nuk e kemi vendosur ende, është Këshilli Organizativ ai që vendosë. Tek çmimet gjithsejtë në kuadër të festivalit janë 9 (nëntë) çmime edhe aty vendos juria profesionale se kush e fiton vendin e parë të dytin dhe të tretin pastaj për depotantin ma të mirë janë juria ata që vendosin e kështu me radhë. Prej momentin të parë që e kemi bërë njoftim in ata e dinë që secili që merr pjesë janë të kënaqshëm me atë mirënjohje për pjesëmarrje. Vendi parë 500, vendi i dytë 300, vendi i tretë 200 çmimi i diasporës 100, e kemi çmimin për depotantin më të ri 100 euro, çmimin e publikut 100 euro.

Liridon Hoti: Përshëndetje të gjithëve ke një pyetje rreth QMF-së në Kijevë për një projekt vlera e të cilit është 22 mijë e 800 euro se qysh dhe kur do të filloj renovimi atje është vendosur prej tyre. Unë mërgimtarëve ju dëshiroj mirëseardhje dhe besoj të gjithë jemi të kënaqur me vlerën e këtij projektit me përjashtim të individëve dhe ja vlen të investohet e jo të lehet për shkak se na vijnë gurbetçarët. Mos të harrojmë jam familje e gurbetçarëve edhe unë e di rëndësinë e tyre i di kërkesat e tyre por edhe për atë pjesë të tyre jemi duke u përkujdes dhe i kemi dy pika jemi duke menduar se a do ta vendosim stafin e Kijevës në Llozicë apo në shkollën ku është afër ambulantes në Kijevë pra jemi në mes të këtyre dyjave se ku do ta dërgojna stafin.

Hajdin Berisha: Përshëndetje për të gjithë po e ceki te ajo pjesa që tha drejtori se jemi shumë koshient se ajo pjesa atje kërkon shërbime deri në ora 22 (njëzet e dy) në mbrëmje dhe nuk po e di a është viti i katërt apo viti i pestë që aty deri në ora 22 (njëzet e dy) ofrojna shërbime por sido që të jetë drejtoria e shëndetësisë me kohe ka mi marrë të gjitha masat që aktiviteti për dhënien e shërbimeve të vazhdoj me kohë edhe pas datës 23 (njëzet e tre) ku qendra e mjekësisë familjare atje do ti nënshtrohet renovimit. Edhe te çështja e festivalit ka kohë ende dhe drejtoresha duhet mi specifiku shumë çështje edhe çmimet do të bëhen publike sigurisht sepse kushdo qoftë që aplikon do të duhej me ditë se për çka garon, se faktikisht e din por elementet që nuk janë bërë publike deri më tani drejtoresha ka kohë brenda javës duhet që të bëhen. Te ndriçimi sa i përket shqetësimeve që u ceken. Jemi tujë u mundu me realizu projektin asht qysh është shkru, mirëpo nganjëherë beson se shpeshherë po hasim në ndonjë çështje siç është rasti me shtyllat. Besoni në Shkozë më kanë tregu që është bërë një devijim i projektit për shkak të shtyllave dhe kam informacion kanë mu ndrru shtyllat edhe në Shkozë. Ka me pas edhe një herë shiçim para pranimit teknik të këtij projekti dhe besoni se nuk jemi tujë e bë qëllimisht devijim e këtij projekti por ka qenë edhe përgjigjen ma ka dhanë mu se afër tensionit te lart punëtorët nuk guxoj mi ofru. Ne buxhet është edhe emri i rrugës se ku ka me shku. Sa i përket analizave te ujit kemi shqetësim edhe na por është kompetencë ekskluzive e hidroregjionit me na ofru analizat bashke me inspektoratin tonë ka shqetësime dhe i ndajna shqetësimet bashkë me juve. Te kanalizimi prej Lladrocit deri ne Malishevë është kanalizim 9 (nëntë) kilometra por aj kanalizim nuk ka përfundu kamë informacione se aty kemi pengesë edhe po kërkojnë rregullimin e shtratit të lumit gjë që neve na paraqet pengesë dhe nuk e di se si do të procediojna më tutje. Me pengesat në rrugë kërkesat kanë shku në ministri dhe shumë shpejt do të zgjidhet problemi edhe te dritat që nuk punojnë shumë shpejtë do të zgjidhet problemi i tyre. Te çmimi i kanalizimit janë autoritetet tjera na çka mujna me bë është najë ankesë por nuk jemi autoritet që mujna me bë diçka në atë drejtim.

Rrahim Morina: Unë e kam nja kërkesë që nga mbledhja e ardhshme ti bini një ditë para mbledhjes kërkesat me shkrim edhe ekzekutivi të ju jep përgjigjet se besoj edhe përgjigjen e merrni ma te plotë. Kërkesat i dërgoni në adresën time zyrtare dhe unë i përcjelli te drejtorët. Unë kërkesën e juaj e protokolloj dhe së bashku me timen ja qoj drejtorit. Unë po e marrë një përgjegjësi dhe po e ngarkoj vetin për me ju lehtsu edhe punën e kuvendit edhe punën e juaj.

Hajdin Berisha: Faleminderit kryesues secili drejtor atje ne Ueb faqe i ka email adresat e veta drejtoju ju me shkrim drejtorëve ose edhe kryetarit te komunës se po ta kqyrum rregulloren as një drejtor nuk mundet me dal ne foltore me fol pa e pasur lejen e kryetarit jo për cenzur por rregull është lexoni edhe rregulloren se si bahen pyetjet me shkri dhe kthehen me shkrim përgjigjet nëse asamblisti nuk është i kënaqur mund te debatoni këtu por drejtoju me email adresë apo qysh do qoftë ekzekutivit.

Rrahim Morina: Hapi debat rreth rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Çështja që unë do ta ngris nëse doni e fusim në rend dite nëse pajtoheni e fusim pa e diskutu fare ka të bëj me pritjen e bashkatdhetarët dhe pritjen e tyre. Unë kam diskutu edhe me komitetin për diasporë ja kam dhanë edhe kryetarit edhe drejtoresha a kanë aty që komuna ta bëjë një dit që ti ftojna bashkatdhetarët të vinë në komunë të jenë prezent edhe anëtarët e asamblesë kush donë aty. Mirë është krejt komuna me bë por së paku nëse nuk e bëjnë ata së paku ne ta bëjna ta kemi një

ditë dhe i presim dhe njoftohen pak për aktivitete tona dhe për punën tonë. Një koktej dhe me bisedu jashtë dhe mos mu kanë veç një orë por ma shumë kjo si ide si te doni ose ne rend dite ose ne parim.

Rrahim Morina: Alban unë e kam një si ide së pari të konsultohemi me kryetarin mos ta bajna ndaras e nëse jo tani kqyrum ne e bajna vetë konsultohemi me kryeshafat e grupeve e flasim.

Sylë Dukolli.- Të gjitha pikat jam për mi shti veç kam vërejtje me gabimet gjuhësore se po ka por nëse nuk ju ndodh krejtve për mue nuk ka problem hiq, por në secilin paragraf ku përmendet emri imë ka shtrembrin ose mungesë te fjalëve. Ti shqyrtojna një nga një pikat.

Alban Mazreku: Unë pajtona pjesërisht me Sylën vetëm kryesues e kam një kërkesë raporti që na ka ardhë sot me vonese raporti i komisionit për emërimin dhe zgjedhjen e kryetarëve neper fshatra të futet si pikë e parë ose e dytë, si dhe pika e dhjetë ne e kemi bërë një kërkesë drejtorive gjegjëse për pishinë olimpike ne te na binë planin e fizibiletetit na ka ardhë diçka tjetër kjo pike të hiqet nga rendi i ditës.

Rrahim Morina: Po pajtona që të jetë pikë e dytë ajo unë një herë po lexoj kërkesën time e cila duhet të shënohet në procesverbal kështu: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02./442 datë 17.07.2019 e parashtuar nga Komisioni për Organizimin dhe monitorimin e Zgjedhjes nëpër vendbanimet, fshatrat dhe lagjet e komunës së Malishevës. Në këtë formë duhet të precizohet si forme e rendit të ditës d.m.th është një kërkesë e Alban Mazreku që pika e dhjetë të largohet nga rendi i ditës me një arsyeshmëri që është kërku një material një sqarim që të bëhet fizibiliteti për dy lokacione të cilat kuvendi komunal i ka përcaktuar për caktimin e pishinës gjysmë olimpike. Njëra është te Mirusha dhe tjetri është në Golesh. Drejtoria nuk i ka përmbush obligimet Albani po kërkon që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës. Kërkesa ime ishte që çështja e zgjedhjes nëpër fshatra të futet si pikë e rendit te ditës. Te pika e dhjetë, kush është që pika e dhjetë të largohet nga rendi i ditës kryetari e ka kërku shfuqizimin e vendimit se aj kërkesën e ka që kjo pishinë mu ndërto në Banjë.

Sylë Dukolli: Pikërisht na nuk jemi kundër investimeve por të shohim se ku kemi ujë të mjaftueshëm se nuk e kemi as një vend tjetër se kamë pasur qejf mu kanë në Bubavec mirëpo po tregohemi tendencioz kundra investimeve që kanë me na ardhë prej qendre ju kishna lutë që me mirëkuptim dhe me sjellje në komunën e Malishevës me investime të reflektoni si po reflekton ekzekutivi për mi thithë investimet nga jashtë. Unë jam kundra heqjes se pikës nga rendi i ditës.

Alban Krasniqi: Kërkesën që bëri Albani një për të heq nga rendi i ditës dhe njërën për të diskutu janë çështje që i kemi diskutu dhe ne pajtohemi që ato të rinë aty dhe të vendoset për to dhe në te njëjtën kohë te pjesa e pishinës gjysmë olimpike kuvendi komunal është aj që vendos për investimet dhe vendndodhjen e tyre se ku ndodhi. Kuvendi komunal e ka marrë një vendim duke u bazuar në 44 (katërdhjetë e katër) fshatra dhe shtrimi te ndodhë sipas shtrirjes që diskriminimi mos të ndodhë si në kohën e komunizmit kur fshatrat që i kanë pasur tre serb ju kanë marue prej a deri në zh senet ndërsa fshatrat që kanë pasur shqiptar dhe kanë kundërshtuar regjimin janë diskriminu e janë lan në lloç komplet dhe logjika e njëjtë po vazhdon me ndodh fatkeqësisht edhe sot dhe mos me ngritë zërin si asamblistë kur ti i sheh dy projekte vinë prej nivelit qendror prej të njëjtit vend dhe rastësisht aj vend është vendi i zëvendëskryeministrit dhe ajo është parja e jonë publike nuk është parja e Fatmir Limës por parja e të gjithëve është dikush nuk ka kanalizim e ju po doni me qu kanale te ujit kjo është e

turpshme. A dini mu ndal more ju najë herë? A është Malishevë edhe Carravrana pse Nismës nuk i bjen ndërmend me qu në Gurbardh pse nuk i bjen ndërmend me bë kanal in e ujit ne Bubavecë në Drenoc, unë pres prej banorëve te fshatit Banjë që ata ta ngrisin zërin vetë se kjo është shumë e ulët edhe vet asamblisti duhet me thane se kanali nuk kanë nevojë me shku ne Banjë se e kemi tepru. Unë mendoj se investimet duhet mu shpërnda se burimet janë edhe në Gurbardhë edhe ne Terpezë, Berishë, Lladroc etj. Nuk banë mi qu senet me tendencë. Ne duke u bazuar ne këtë ne kërkoj na prej drejtorive përkatëse me naj pru sqarimet dhe propozimet për dy vendodhjet e mundshme ku muni me rregullu edhe bazenin e Banjës që e keni lanë prej vitit 72 (shtatëdhjetë e dy) në mjerim kush nuk a marrë me ta. Hajdi ta ndrequm basenin e Banjës dhe ta rregulloj na e ta laj na në shfrytëzim publik që të paguajnë qytetarët aq sa ju takon e jo te paguajnë si tash kur nuk lëshon kupon as kurr gjë hiq shkeljet janë edhe të karakterit tjetër. Infrastruktura që e përfshin tërë territorin e Komunës së Malishevës ne ta përfshin krejt me pas një farë llojë barazie që ju jepet njerëzve e jo veç me një ven.

Alban Mazreku: Nuk është tendencioze Sylë se vetë ministri Kujtim Gashi është nga radhët e PDK-së edhe aj e ka shprehë interesimin e investimeve në komunën e Malishevës edhe për pishinën dhe sallën e sportit në drenoc kështu që nuk janë tendencat aty por janë se nuk e kanë kompletuar materialin aty as për fshatin Banjë nuk e kanë pru të kompletuar as për lagje e as për Mirushë. Kërkesa jonë është arsyeshmëria se pse po hiqet është mungesë e seriozitetit të drejtorëve të qeverisjes begaj që nuk po na furnizon me material.

Nebih Bibaj: Përsëndetje për të gjithë Sylë ku ka qenë interesi qytetar kemi qenë aty e kur nuk është interesi qytetar nuk jemi aty. Te Banja se kamë qenë një dit mu la aty thjeshtë projektin se si ma spjegun aty baseni i vogël duhet mu eliminu e ku mu la fëmija. Se për pishinë olimpike në cilin do fshatë ka ujë dhe për mue eliminimi i basenit të vogël është shqetësuese dhe për këtë arsye jemi kundër.

Rrahim Morina: Kjo është një përgjegjësi e qeverisjes komuna se kuvendi e ka kërku e një sqarim një fizibilitet dhe kuvendi nuk është lodhur fare mi pru senet. Bjere ti kryeje punën tënde dhe bisedoj na më tutje. Kuvendi e ka obligu me pru për dy lokacione vendimi është nxjerrë edhe ju kamë dorzu dhe nuk e di se pse nuk kryhet puna.

Arbëreshë Krasniqi: Përsëndetje të gjithëve një pjesë dërmuese duke përjashtuar LDK dhe VV-në pjesa tjetër jemi në një qeverisje bashkë pavarësisht asaj se dikush mund të del më ndryshe me investime ne komunën e Malishevës të paktën këta zërë nga kolegët e nivelit qendror nuk do doja që të diskutohen. Unë e di që secili asamblistë i PDK-së mundet me shku ne ministrinë gjegjëse dhe mu sqarua se pse ky investim duhet që të shkoj në Banjë. Unë e di që asambleja e ka për detyrë që të vendos për lokacionin për investimet qendrore megjithatë asambleja e ka një përgjegjësi në kontekst racional dhe të diskutoj pse. Unë e di që as një asamblistë i nuk është kundër fshatit Banjë por nga mendësia e ngushtë e tentojnë ta penalizojnë gjithë fshatin, ky është gabim secili prej neve duhet te analizoj qartë pa u ngushtuar. Çështja e projektit në Drenoc nuk ka humb aj projekt do të realizohet fshati do të jep fjalën e vetë dhe do të shkoj aty ku duhet. Është hera e parë prej shumë qeverisjeve që kemi mundësi si komunë me thithë investime nga niveli qendrorë dhe kjo është për mu gëzu e tani ku shkojnë është çështje tjetër që sigurisht i mbetet kuvendit dhe jam për me i respektu vendimet e kuvendit mirëpo gjithmonë karshi mundësisë. P.sh se pse duhet të shkojë në banjë, unë konsideroj që pika e parë është mundësia e ujit dhe në shumicën e rasteve përfaqësuesit e vetëvendosjes kanë ngre

dilema rreth basenit të banjës dhe unë konsideroj rreth këtyre investimeve ka mu rregullu edhe ajo pishinë. Nëse ju kemi mungesë dokumentacionet unë jam për mi pritë ne si kuvend dhe për mi dhanë vërejtjet atyre që është dashtë mi bë ato punë dhe nuk i kanë bere por jo me devijua projektin por të shkoj aty ku duhet dhe ne të jemi racional dhe jo me ide të ngushta tonat.

Halil Morina: Përshëndetje dhe faleminderit që po thu mos me fole jashtë rendit të ditës, por unë pikërisht jam tujë fole për pikën e dhjetë të rendit të ditës. Kur ne po flasim për këtë pishinën gjysmë olimpikë, natyra i përcakton në një farë mënyre. Po të ishte me maru najë shtëpi të kulturës në Banjë unë do të isha i pari kundër asaj, mirëpo kur flitet për ujin tani vendbanimet e komunës tonë kanë disa resurse natyrore siç është rasti me Banjën uji dhe kjo është krejt normale me bë investime dhe me pru projekte dhe ato resurse mos me hupë. Edhe unë jam i pajtimit që është deshtë mu bë studimi i fizibiliteti dhe mu pas kanë me najë vendbanim tjetër ku fizibiliteti kish tregu që është më e përshtatshme mu maru dikund tjetër prapë une jam për me votu. Mirëpo unë me bindjen time konsideroj se edhe mu ba aj studim prapë ka me dalë aj lokacion aty kua. Nuk e di sa ka hapësirë për mu maru ajo pishinë, nashta ish kanë mirë mu pru najë letër se ku ka mu maru apo mos po bahet dëm najë kund apo jo. Mirëpo kisha thanë që mos me hjekë prej rendit të ditës kit pike por prapë vendosni ju.

Rrahim Morina: Propozimi i Alban Mazrekut është që pika e dhjetë e rendit të ditës të hiqet se ekzekutivi nuk i ka përmbushë obligimet lidhur me fizibilitetin. Kush është me hekë pikën e dhjet nga rendi i ditës: Për 14, kundër 5, dhe abstenim 1, hiqet pika e dhjetë nga rendi i ditës. Një kërkesë edhe imja është shqyrtimi i kërkesës nr. 02/ 442 datë: 17.07.2019 e parashtruar ne këtë rast po ja la komisionit nese pajtohesh Alban nga Komisioni për Monitorimin dhe Organizimin e Zgjedhjes së Kryetarëve nëpër Vendbanime Fshatra dhe Lagje të komunës së Malishevës kush është për: Për 14, Abstenim 6, hyn në rend të ditës pika nr. 2 që e lexova paraprakisht shkojna në votim të rendit të ditës ne tersi. Kush është për? Për 14, Kundër 1, Abstenim 5. Pika e parë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e IV.

Sylë Dukolli: Unë kur te me vjen ftesa ne seancë me të vërtet nuk po i njoh fjalitë e mia nuk po du me bë me gisht por po du veç mëm dalë fjalitë e mia. P.sh çdo projekt duhet te jetë, bnj. Por për mos me hi besoni çdo fjali ka gabime. Unë po thamë se ndoshta tastatura i ka fajet se gishtave nuk du me ju lan fajet përmirësoni ju kisha lutë që herën tjetër te me vjen e shkrume ose mos ma qitni hiq se gabim nuk du, se me jetë ne arkivë.

Rrahim Morina: Kush është për? Votimi është për unanim me vërejtje kaloni mirë fillojna ne orën një e pesëmbëdhjetë.

Pika e dytë është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës: 02/442, dt 17.07.2019 parashtruar nga komisioni për monitorimin e zgjedhjes së kryetarëve nëpër vendbanimin dhe lagjet e Komunës së Malishevës. Meqë kam qenë kryetar i komisionit do të dalë të prezantoj punën tonë pastaj do të hapim debat. Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës do të mundona që të jem sa ma i shkurt me qëllim që të ju japim hapësirë këshilltarëve që ti japin ata kritikrat dhe propozimet e veta. Kuvendi komunal e ka themelu komisionin me datën: 13.03.2019 ndërsa më dt: 29.03 është bërë konstituimi i komisionit dhe me datën: 17. 05. është zgjedhur kryesuesi i komisionit ku jam zgjedhur unë Rrahim Morina. Komisioni e ka pasur këtë përbërje nuk po e lexoj e keni në raport gjithsejtë i kemi mbajtur 9

(nëntë) mbledhje nëpër zyre dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) i kemi mbajtur takime në teren. Gjithsejtë 46 (katërdhjetë e gjashtë) në të gjitha vendbanimet duke i përfshirë edhe tri fshatra që nuk figurojnë në statutin e komunës por që ne i kemi mbajtur dhe i kemi zgjedhur edhe kryetarët edhe kryesinë, procesi ka shku mirë me përjashtim në disa fshatra ku na kanë detyru me shku ka dy tri herë ndonëse edhe kryetarët nuk kanë qenë të gatshëm me organizu një takim të tillë por marrë në përgjithësi procesi a krye me sukses. Kemi fillu me datën 10 qershor dhe kemi përfundu me datën 15 korrik, ne si komision i kemi bërë të gjitha publikimet, oraret e takimeve dhe janë njoftu nga dy ditë dhe tri ditë përpara se kuvendi mbahet me datën kaq në ora kaq. Nuk ka mungu informacioni por kemi pasur rast që kryetarët nuk e kanë krye informacionin nëpër fshatrat e tyre, na kanë përcjellur disa telashe por marrë në përgjithësi ka qenë një proces i përfunduar mirë. Unë çka dua ta veçoj se vetëm me një fshatë ka marrë pjesë një femër dhe ajo ka hyrë në garë por nuk ka fitu pra fjala është për fshatin Ngucat. Për mos me ju marrë kohe unë do ti lexoj disa rekomandime që komisioni i ka nxjerrë ato rekomandime duhet të votohen në kuvend

1. - Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Komisionit për Përzgjedhjen e Kryetarëve të Fshatrave në Komunën e Malishevës së bashku me Listën e Kryetarëve të Fshatrave, që e keni edhe ju dhe Listën e Kryesive të Kryetarëve të Fshatrave të zgjedhur në zgjedhjet e qershorit 2019 që d.m.th janë tri dokumente por që është një tërësi që duhet të votohet: është Raporti është Lista e kryetarëve të Fshatrave dhe është Lista e Kryesive të kryetarëve të fshatrave.

2 – Inicimi dhe ndryshimin e rregullores nr 02/95 të datës: 05.05.2011 për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve në komunën e Malishevës. Kjo qështje duhet të iniciohet në mbledhjen e gushtit për shkak që e kemi debatuar edhe çështjen rreth pagesës dhe nën tre pagesa e kryetarëve të fshatrave të jetë ekuivalente me anëtarët e komitetit për politik dhe financa pagesa të fillon nga data një janar 2020 dhe të inkorporohet në rregulloren për monitorimin e kryetarëve nëpër nëpër fshatra dhe lagje të komunës së Malishevës dhe deri atëherë ne nuk kemi planifikuar buxhet për kryetarët e fshatrave deri atëherë kjo nuk mund të hyjë në buxhet. Tash bëhet planifikimi për vitin 2020 dhe mendoj që është ekuivalente dhe e dinjitetshme për shkak se në një takim që e kemi mbajtur në Pejë në një takim për kornizën afatmesme ku zëvendësministri Gashi na ka thënë që zbatimi i pagesës do të fillojë nga një dhjetori dhe sipas tij mëditja e antarit të asamblesë komunale do të jetë 125 (njëqind e njëzet e pesë) euro edhe komiteti për politik dhe financave dhe ne të ju rritet edhe kryetarëve të fshatrave. Dhe një kërkesë tjetër është kërkesë për mu të bëjë pagesa e komisionit edhe për mbledhjet tjera se për shkak që na kemi marrur vendim që të paguhet 6 (gjashtë) mbledhje në zyre dhe 11 (njëmbëdhjetë) në teren, një kërkesë e tillë ka burim për shkak se komisioni ka shku nëpër disa fshatra ka dy tri herë dhe sipas tyre ka shku një shpenzim bukur i mirë dhe sipas tyre duhet mu pagu si komision për monitorimin e zgjedhjeve. Unë nuk kam më tepër po presim për debat rreth kësaj çështje.

Sylë Dukolli: Rreth raportit apo këtë procesverbal që e pasqyron gjendjen rreth zgjedhjes së kryeplakëve apo kryetarëve të fshatrave unë desha ti bëj disa pyetje. E para është dashtë procesverbali të përmbajë edhe ato marrëveshjet dhe ato bisedat mes komisionit. E dyta mundet dikush me na sqaru na veç pe shohim çka është puna me Kijevën nuk është kry si duhet ose është kry si duhet edhe e treta ju si komision të cilët me të vërtetë e keni pasur vështirë në teren se na e kuptojmë që në secilin fshat me shku duhet dikush me e organizu pritjen madje duhet me qenë përfaqësim i denjë i lagjeve gjë të cilën e besoj fort se nuk ka ndodhur ajo për hir të asaj që njerëzit tash ma pak janë të prirur me këto aktivitete. A keni far udhëzimi dhe a keni pasur diçka të shkruar me shkrim që mi njofto asamblistët me atë se cilat janë detyrat e kryeplakut sepse në rrjedhën normale ma shumë kryeplak që merr krye në veti

vendime madje ato kryesi që zgjidhen ato janë formale sepse në fshatin temë e keni pa jam tërënjë për arsye se nuk kam dashtë me qu ma gatë me kry punë dhe kështu njësoj janë edhe fshatrat tjera. Edhe një herë ju kërkojë sqarime për pyetjet dhe cilat janë detyrat dhe përgjegjësit e kryeplakut dhe udhëheqësit të fshatit cilat janë të tina dhe kanë e pret aj në emër të fshatit kanë e pret aj dhe çfarë zyrtari duhet që të jetë kryeplaku cilat punë duhet ti kryejë kryeplaku.

Rrahim Morina: E keni rregulloren neni 7 dhe neni 8, bile neni 8 i përcakton detyrat e kryesisë d.m.th janë të specifikume për kryetarin dhe kryesinë nëse nuk e ki rregulloren muj me ta dhanë. Të gjithëve kryetarëve të fshatrave ju kena shpërmda listën e banorëve dhe rregulloren e kryetarëve të fshatrave dhe ktu çdo gjë është e precizume. Ne e kemi procesverbalin dhe shkruan në procesverbal për te gjitha kuvendet por në raport ju kemi ikë atyre veç çka ka rreth kryesisë se ka ndodh e kanë zgjedh kryesinë ku ka qenë vetëm Luan Kryeziu por për ato e din Nebihi për komisioni për Kijevë nëse e ke vërejt është një model për te gjitha fshatrat. Të dhënat janë të vitit 2011 të dhënat merren çdo 10 (dhjetë) vjet.

Nebih Bibaj: Faleminderit do të fokusohemi tek Kijeva pasi edhe aty e kam kryesu komisionin. Ne kemi shku aty me komision kemi shku me vonesë nuk na ka hap drejtori shkollën hiç por është vonu edhe kryetari, kur kemi prit gjysmë ore në Kijevë. Kemi hy brenda aty kemi fillu me procedurat normal me shpjegimin e rregullores së pari tani me pjesën tjetër, kur janë ardhur në kijevë kanë qenë tri lagje edhe katër nuk kanë qenë të përfaqësuese po flas gjithmonë për herë të parë kur jemi shku aty ka ardhë edhe Sejdi Brerisha kryetari aktual, ka ardhë me vonesë të madhe. Kur jemi shku në atë pikë kanë lind debatet më të ndryshme edhe në atë kohë, kryetar i Sejdi Berisha na ka leshu takimin gjë që ne nuk kemi mujt me vazhdu mbledhjen pa prezencën e kryetarit ose nënkryetarit aty. Kështu e thotë edhe rregullorja edhe kanë qenë aty edhe tri katër lagje që nuk kanë marrur pjesë. Unë si kryesues i komisionit së bashku me anëtarët e tjerë të komisionit kemi marrur vendim së bashku anulimin e asaj dite në Kijevë. Atë ditë Luan Kryeziu ka dalur jashtë rregullores i cili e ka mbajtur takimin në Kijevë pa prezencën e kuorumit dhe komisionit e ka majtë takimin dhe e ka zgjedhur një kryetar të një anshëm dhe e ka zgjedhur kryetrarin e vetë në Kijevë. Ata kanë prurë kërkesë se gjoja e kanë zgjedhur kryetarin por komisioni e ka refuzu kërkesën. Jemi shku për herë të dytën në Kijevë nuk ka pas përfaqësim të lagjeve dhe unë personalisht me komisionin e kam anulë takimin. Edhe herën e tretë kur jemi shku me komisionin e kemi zgjedhur kryetarin dhe është Bashkim Gashi me votat e komisionit është zgjedhur me përjashtimin e dy lagjeve nuk kanë ardhë ajo lagjia që e ka zgjedhur kryetarin e vetë kryetarin e Luanit se na kështu e kemi quajtur në komision vazhdimisht, në vendin ju kemi lanë në kryesi asaj lagje dhe kështu ka shku procedura deri në fund. Por kit konfuzitet edhe Luani ma nuk ka ardh kurrë sepse ka thënë që unë kryetarin kam zgjedhë, dhe kjo ka qenë si kronologji e ngjarjes se Kijeva ka qenë rast ma specifik vetëm për kit arsye.

Hidajete Mazreku: E patëm prononcimin tënd lidhur me raportin për përfaqësuesit e fshatit ose të qytetit kryetari ose kryeplaku drejt me than unë kamë edhe shqetësim lidhur me kitë komision sepse nuk janë shpallur zgjedhje nëpër lagje, ku kamë rastin në Malishevë vetë kamë qenë prezent që lagjet e Malishevës nuk i kanë mbajtur zgjedhjet ku përfaqësuesit janë emëruar edhe vetë. Edhe në seancën e dytë që keni pas edhe njëri thotë se unë du mu emëru se ata tjerët vetë janë emëru. Unë po du me thanë duhet të mësohemi kolegë asamblist në mënyrë demokratike ti tregojna botës pa marrë parasysh fshatin ose qytetin se kush do në të jetë. Boll kemi prolongua nga kjo që kemi pasur gjer më tani që janë zgjedhur kush ka dashtë për mu përzgjedhë. Me plotë sinqeritet po ju thamë kam pasur dëshirë që ne të

jemi shembull edhe të fillojina nga lagjia se nëse përfaqësuesi i jemi i lagjës nuk me përfaqëson mue atëherë aj kot e ka me përfaqësu krejt qytetin e Malishevës. Lagjia është celula e parë. Përfaqësuesi i Malishevës pika e parë e tina ka qenë me zgjedhje të bëjë publikimin jo vetëm në ueb faqe të komunës por të bëjë publikimin nëpër të gjitha lagjet e Malishevës që do të mbahen zgjedhjet nëpër lagje edhe ata përfaqësues të lagjeve kanë mu përzgjedhë aty ka qenë vetëm një seancë mu përmbyllë ajo nuk ka pasur nevojë mu debatu sikur që kam pa unë polemika se jam befasu se kurrë nuk kamë marrë pjesë nëpër këto përfaqësues mirëpo sa unë u informova, prej Gjëmajli Bajrës prej komunizmit e deri qitash vetëm nga dy tre përfaqësues janë marrë vesh dhe u krye edhe u bë kryeplaku i atij fshatit. Ju e dini se mos me hy në qendër atje se si janë senet me kryesuesin e qeverisë se çka janë ka bëjnë. Kush e dëgjon ma përfaqësuesin e lagjes se çka banë ma kur nuk është zgjedhur nga lagjia p.sh, se unë kur e kamë përfaqësuesin temë unë nuk kamë nevojë me vetë kryeplakun se çka je ka banë i thamë atina përfaqësuesit temë hej lagjen teme e ki dhe gjithmonë orientona unë te përfaqësuesi jem. Unë nuk kamë pa kryesues delegim tjetër qe ku jam unë që kamë asistua në seancën e parë nuk kamë qenë nuk kamë pasur qasje se telefoni mu ka prishë e kamë pasur në riparim edhe nuk jam informu. Në seancën e dytë jam informu nga zyra e kuvendit komunal dhe jam informu që do të jetë mu atë ditë por jo atë dit me tregoni dy ditë ose tri ditë përpara. Në këtë komision nuk ka ndodhe dhe me plote keqardhje jam tujë i shprehë edhe indinjatë e kamë të thellë pse me vepru qishtu. Nuk është vetëm Malisheva është Banja, Bellanica, është përzgjedhë gjithë Jusufi sikur tito se çdo herë aj ka me qenë kryplaki i katundit nuk është ajo votë dhe unë ti bi njerëzit e Bellanicës të ri që më kanë thanë që është bërë keqpërdorim për Bellanicën ti bi njerëzit, për Drenofcin ju lutna se komisioni nuk munet me mbajte mbledhje pa kryesinë. Monitoruesi nuk munet me majtë kryesinë pa e pasur përfaqësinë e fshatit apo të qytetit, ti nuk ke pasur përfaqësues ti momentale e ki zgjedhur përfaqësuesin e lagjes. Vetë ka kandidu unë du mu bë edhe pikë a e ke pasur najë kanë ne Malishevë qe ku është Rifati a u deklarua vetë unë du e lejon në lagje mirëpo jo ne përfaqësimin që me zgjedhë kryeplakun e nëse lagja nuk e voton aj nuk mundet me shku përpara. Vetëm edhe diçka po më vjenë keq tek përfaqësimi gjinorë drejtë me të thanë kur e kamë pa fletën një femër ka qenë qysh mundet ju komisioni nuk keni pasur kurajo me pas zgjedhe vetëm një femër se unë nuk kishna mujt mi bë gjitha këto punë një femër ka kandidu dhe ka qenë në kryesi brenda nuk e kanë votu. Kjo de te na shkon me dekada rresht se vetëm kryeplaku zgjidhet e kryeplakë jo. Femra ka pas, mirëpo mu nominu nuk janë nominu se edhe ne Malishevë ka qene femra nuk është nominu. Dua një herë dhe përgjithmonë mu vnu rendë prej lokalitetit deri te kryesia atje neltë. Opinioni imë është që gjithmonë prej fillimit të jetë tek lagjia dhe drejtpërdrejtë aj të komunikojë me kryeplakun përfaqësuesit e qytetit ose fshatit. Kjo duhet me rregullore duhet mu ndryshu se ndoshta nuk është përfaqësues i lagjes hiq. Për këtë arsye që thashë prej Gjëmajli Bajrës edhe deri qetash çdo herë janë zgjedhur njëjtë, unë kamë mendu se në këtë zgjedhje do të jemi ma cilësorë ma demokratikë do te kemi qeverisje demokraci mirëpo drejt me thanë unë në Malishevë që kamë qenë prezentë për mu ka qenë boll që jam njoftu me opinionin. Edhe kriteret për përfaqësues të lagjeve, cili kriter merret për shembull? A merret shtëpi? A merret banorë sa janë aty? P.sh për 9 (nëntë) përfaqësues 11 (njëmbëdhjetë) përfaqësues ka 2 (dy) te ni lagje ka 3 (tre) te ni lagje mue kjo më ka bërë mu shqetësu pse me bë dallavere, kjo ne te jetë mësim edhe për gjeneratat e ardhshme. Cili le të vije në pushtet mirëpo me zgjedh çështjen se si duhet prej lokalitetit gjer tek nalt me shku dhe për këtë arsye kryesues unë i thashë se thojke kryesuesi e thirri policinë por unë i thash se jam e zoja që edhe ma herët kam qëndru.

Arbreshë Krasniqi: Faleminderit unë fillimisht e përgëzoj komisioni për punën që e kanë bërë koga e mundimshme i falënderoj për punën dhe angazhimin unë e di që në shumë raste thuhet që këta anëtar paguhen por munda dhe problemet që munda të ndodhin nuk paguhen. Fatbardhësisht Malisheva e ka përmbysur edhe këtë proces dhe formën se si ka shku kryesuesi e tha por jam e informuar edhe nga anëtarët tjerë që kanë qenë nga radhët e nismës socialdemokrate e di që në disa raste ka pasur edhe shumë problematika ka shku një proces i rregullt ka përfunduar një proces i përzgjedhjes së kryetarëve të fshatrave nuk ndihem mirë që nuk ka shku askush i gjinisë femërore nuk është e mirë por ka ndodhë nuk është e mirë po ka ndodh dhe ne e patëm rastin një kryesuese me pas grua por nuk e kemi nuk d.m.th detyrimisht me qenë grua por me qenë meritore dhe me përfaqësu fshatin dhe mu kanë meritore mi qu proceset përpara. Urime të gjithë kryetarëve të përzgjedhur dhe shëndet të gjithëve i përgëzoj edhe anëtarët për punën që e kanë bërë.

Alban Krasniqi: Shkurt kryesues: e para puna e kryetarit të fshatit është punë e rëndësishme por jo e rëndësishme në dimensionin qysh po e bëjnë disa që pe marrin dhe e kanë marruar së paku qeverisja deri më tani. Edhe mendoj që duhet me ra në vend rëndësia e tij pa marrë parasysh kryetari se ka munda me anu politikisht për me nejt ma shumë dhe për mënyrën se si mundet mi adresu kërkesat e banorëve atje edhe këtu mbetet shumë për me dëshiru. Procesi si i tillë ka qenë ndër proceset më të mira mirëpo larg asaj më të mirës që muja me pretendu. Nashta dikush ka mujt mos mu përfaqësu as te lagjia dikush nashta nuk është as i njoftuan me kohë, por një gjë duhet me pasur parasysh e sidomos ju asambleistat pa dallim këtu ju megjithatë i merrni ka 100 euro në muajt së paku 200 euro ju jetë paga në fund të muajit mos pritni juve lartmadhëria e juaj me ju lajmeru e me ju njoftu me kohën kur duhet mu kanë zgjedhjet nëpër lagjet e juaja edhe hajde mu ose nuk mu me ardh mu ka prish ose nuk mu ka prishë telefoni. Ju jini të obliguar mi njoftu lagjen e juaj na jemi secili lagjen tonë e kemi obligim moral sepse aj organizim është organizim vullnetar. Komisioni e monitoron procesin edhe nuk e len për mos me dalë prej kornizave normal krejt rastet nuk ka mujt me merr të gjithë e dini se një pjesë e juaja jini kanë edhe në këto procese edhe e dini se çka kini hekë për me ardh te një kryetar i përshtatshëm që unë besoj mi krahasu me kryetarët tjerë kryetarët që janë zgjedhur tash pa përjashtim ose me najë përjashtim shumë të vogël të themi mendoj që kanë një përvojë qyshe mundet mu vepru edhe qysh nuk mundet mu vepru në të ardhmen. Mirëpo për organizim të lagjes këtë detyrë e kena pasur të gjithë ju dhe ne edhe nuk kamë marrur pjesë në proces si Alban. Unë e kamë pasur obligim realisht mi njoftu krejt vet mu interesu mi njoftim se ktu kur lypen do detyra sidomos prej kuvendit prej kryesuesit se duhet me ditë që ky është një njeri. Ky proces a kanë i të gjithë neve përgjegjësi me organizu sa ma mirë dhe unë mendoj që rekomandimet edhe vërejtjet që u dhanë se patë vërejtje të merren për baze dhe ato të adresohen. Mirëpo adresimin e tyre unë e gjej tek rekomandimet që i keni nxjerrë edhe tek pjesa e rekomandimeve, është pjesë e rregullores dhe rishikimi i rregullores na bënë neve të bazojmë vërejtjet tona ndaj asaj rregullore dhe vërejtjet tona nga përfaqësimi i lagjes e deri nalt ti adresojna. Ama një sen mos e harroni është organizim vullnetar dhe në organizim vullnetar dhe të njoftoj me ato mjete që mujt me të njoftu nëse ti nuk je qytetar aktiv mos prit që unë me te marrë, por shkoj vetë zgjedhna se është organizim vullnetar. Është për mi vlersu se kanë ardhë njerëzit. E para rregullorja kryesues dhe secili që dul këtu edhe unë që dola e kini obligim se ka vinë ato propozime praktika që e mundësojnë sipas nivelit të organizimit atje nuk munesh me thënë që në një lagje nuk zgjidhen kaq njerëz procesi duhet me përfundu. Në Astrazup ka përfundu procesi pak ka rëndësi a më pëlqen a nuk më pëlqen kryetari që e kanë zgjedhur se kah mundet me anu aj, me rëndësi është puna e tij tash dhe masë. Fakti që janë mbajtur ka dy tri takime janë përsëritë tregon ka pasur aty gjithëpërfshirje edhe përfaqësimi edhe

cilësia. Tjetra kryesues ka të bëjë me rekomandimin për kompensim edhe me pëlqej kjo puna e vitit 2020 në këtë rekomandim, rekomandimin ta korigjojna pakë edhe ta bajna që kta mu fillu mu taku realisht prej shtatorit të këtij viti mjetet unë e bërë një përllogaritje ndonëse aty ishin dalur, 46 (katërdhjetë e gjashtë) fshatra nuk e di kriteri si a marrë edhe këtu ne rregullore duhet mu përcjellë. Unë e di që është një Plloqicë nuk ka dy Plloqica pra rregulloni edhe këtë çështje që mos të dalin keqë. Edhe që pagesa prej 50 (pesëdhjetë) euro që unë pajtona plotësisht të fillon të bëhet prej muajit shtatorë që së paku kta që i kemi zgjedhë të fillojnë sepse qysh i kemi lanë në çfarë gjendje ku as shpenzimet minimale nuk kanë mundur mi pas dhe ata janë ardhur me buxhet të vetin, nashta najë një prej tyre ka përfitu diqysh dika por shumica janë ardhë pa aspektin e mundësisë së përfitimit. Pra dikund 8,800 (tetë mijë e tetëqind euro) euro po i bjenë prej 44 (katëdhjetë e katër) fshatrave besoj që mbi 10,000 (dhjetë mijë) euro nuk na dalin prej shtatorit edhe kompensim. Unë mendoj që nuk shkon me seanca se ky është gabim edhe i juaji se qysh e keni mendu. Kjo bëhet me muaj nuk ka kuptim një komision që i ka mbajtur do mbledhje mu pagu qitash se sa një anëtarë i komisionit e me nejtë për katër vite aj kryetar i fshatit se pagesa duhet mu bë mujore. E nëse dikush është jo i përgjegjshëm me punën e tij qysh a ngarku me pozicioni e punës së tij aj edhe shkarkohet bile edhe ne rregullore mujna me shti edhe kur shkarkohet edhe atje edhe prej nivelit ktu mundet mu shkarku por kto janë aspekte që ma vonë mujna mi diskutu. Puna e pagesës mu përfshi dhe pagesa mu kanë mujore se ata njerëz kanë shpenzime se ata duhet mu matë me mbledhjet që i majnë atje jo këtu pasi është organizim vullnetar nuk mundet mu matë performanca e ne ja bajna mujore pagesën veç në aspektin ligjor të diskutohet e që unë mendoj që nuk ka problem në këtë drejtim. Kompensim për shpenzime jo pagë tani se si e rregulloni, ajo në aspektin financiar administrativ dhe ligjore dhe kjo mu rregullu prej shtatorit.

Rrahim Morina: Një gjë duhet ta kemi të qartë unë pse e propozova prej një janarit për shkak se ne mund ta bajna planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm unë e llogarita dikund rreth 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) mijë euro po del për tërë vitin mi pagu kryetarët e fshatrave ne kemi thanë se prej një janarit ka mu bë 125 (njëqind e njëzet e pesë) euro dhe këtyre ne te ju rritet përafërsisht paga ekuivalente me komitetin për politike dhe financa. Dëgjoni edhe Stapanica edhe Plloqica gjithmonë e kanë zgjedhur kryetarin se 44(katërdhjetë e katër) janë në statutin e komunës gjithmonë kanë shku në kit forme edhe nuk qon peshë dy kryetar i pagujna më tepër. Vetëm diçka kjo nuk është page por mëditje dhe po pajtona jo me mbledhje por mujore. Ja bajna edhe kështu për me bë atë të domosdoshme se nëse aj nuk merrë pjesë në seancën e ftuar në këtë rast nga kuvendi dhe kryetari atëherë i ndalet mëditja qatë muaj. Drejtori për buxhet kështu na ka thënë: të gjitha mëditjet mund të paguhet në buxhet për shërbimet tjera komunale kontraktuese.

Ali Morina: Është mendim i jemi personal jo i grupit unë mendoj që kjo pagesa e kryetarëve të shkoj me mëditje sa takime ti majnë në asamble kur i fton qoftë legjislativi qoftë ekzekutivi se unë mendoj mos po hyna në hakë edhe me anëtarët tjerë të kryesisë. Kryetari i një fshati e thirre kryesinë e fshatit po nalana prej Astrazupit 11(njëmbëdhjetë) anëtarë edhe ata po nalna kanë me hupë ditën bashkë me kryetarin atëherë kryetari po e thirrka një takim me anëtarë të vetë për një mëditje e anëtarët e kryesisë që janë aty edhe ata e hupin kohën mundin. Unë mendoj që kjo është e logjikshme të paguhet mëditja ata kur vinë dhe kontribuojnë për fshatin e vetë këtu.

Alban Krasniqi: Nuk është në rregull nuk po më pëlqen qasja e juaj, unë e kamë edhe një propozim tjetër për punën e komisionit se komisioni paguhet veç për një mbledhje atje nuk ka komisioni tri herë

ka shku atje tri herë me pagu. Unë po ju tregoj nuk e përkrahi këtë pjesë as nuk votoj ka 1000 (një mijë) euro mi marrë njerëzit pare publike është nuk ka ktu standarde të 500 (pesëqind) fishta vetë llukë, llukë pare me shti në gjep a 50 (pesëdhjetë) euro në muajt një kryetari të fshatit shkoni ma bëni debat këtu. Aj kurrë mos te vjen në takimet e Ragipit e as te Albanit se sen nuk ka çka ninë këtu, atje ne ta kryen punën e vetë ne ti manë ne ti monitoron investimet që ndodhin, në të kujdeset për nevojat e fshatit, qajo është puna ajo punë nuk shkruhet ajo punë vlerësohet ma vonë dhe kanë tregu rezultat me punën e tyre atje. Kjo puna ma së pari mja nal paret nuk është etike qysh po diskutohet nuk është as produktive është në kundërshtim me vetë procesin që e kena nxitë. Na e kena nxitë një proces me zgjedh njerëz sa ma përfaqësuese që punojnë e tash kur flitet për 50 (pesëdhjetë)euro në muajt bahet temë ktu se qysh mujnë mi marrë. Më herët nuk ka pas të bëjë se a kanë ardhë për çato 30 (tridhjetë) euro por janë bërë do anashkalime ndajë kryetarëve të fshatrave edhe për motive politike edhe për motive tjera që me dhënë një justifikim. Nëse na kena mrri në këtë nivel për mi marrë 50 (pesëdhjetë) euro aj për shka me ardhë në takimin e Ragipit ma mira hiq nuk ka vy me hi në këtë farë procesi me hargju pare edhe me lanë krejt këtë punë. Me pas ardhe ju 4 (katër) vjet këtu ju pa pare, e kishit kallë këtu. Për nivelin e tyre se sa janë e kanë dhënë provimin e tyre së paku për qit dimensionin moral por ti kemi parasysh punët që i bëjnë jashtë çasaj pjesëmarrje por jo me ju detyru. Edhe te pjesa e kompensimit kujdes se qysh e bëni të komisionit, për 46 (katër dhjetë e gjashtë) fshatra kini thënë dhe secili ku ka marrë pjesë ka mu kompenzu edhe nëse ka majtë mbledhje dhe ka procesverbal e jo nëse ka dështu një mbledhje mu pagu. S'ka për Bubavec një mbledhje ka mu pagu nëse ka dështu edhe aj kryetari i fshatit ka ardhë e aj nuk po paguhet edhe po ja nzerrum sytë atij e këtu vetës po valla kjo nuk është e logjikshme dhe unë jam kundër kësaj mënyre. Në secilin rast 46(katërdhjetë e gjashtë) zgjedhje 46 (katërdhjetë ne gjashtë) pagesa.

Alban Mazreku: Edhe unë si parafolësit e mi po e përshëndes punën e komisionit se komisioni nuk e ka pas lehtë punën në teren. Deshta mu ndërlidhë edhe te Hidajetja kur e përmëni mbledhjen e parë se nuk është njoftu as në mbledhjen e parë për Malishevë, unë personalisht vetë e kamë thirrur profesoreshën Hidajete por atë ditë nuk e di se pse nuk ka mujt me marrë pjesë. Qitu te rekomandimet a kanë mirë ose kur bëhet iniciimi i ndryshimit të rregullores me parapa edhe raportin e tyre për kuvendin ose përmes kryetarit të komunës mi raportu kuvendit komunal Malishevë. Ne Kryesues si propozim pe japim me mëditje Kryesues me shku kur ti majnë takimet mu pagu edhe ata 50 (pesëdhjetë)euro.

Rrahim Morina: Vetëm pak ju kisha lutë janë dy propozime: Njëri propozim është që të paguhen me mëditje dhe tjetri është propozimi, po i përmendi edhe me emra: Alban Krasniqi ka propozu që mëditja të jetë e rregullt për çdo muaj dhe të jetë 50 (pesëdhjetë)euro, ndërsa Alban Mazreku propozoj që me i pagu me mëditje se si marrin pjesë në mbledhje është fjala në mbledhjen e kuvendit jo në fshat. Unë para se me hedhë në votim këto dy propozime unë personalisht jam me mujore për shkak se edhe ata kanë nevojë se kanë aktivitet. Unë e falënderoj komisionin për punën e vetë e veçanërisht Raimondën edhe profesoreshën Filloret që na kanë shoqëru besoni në një rast nuk du me përmend katundin profesoresha i tha si nuk të vjen turp në prezencën time mi folë këto fjalë. Ka pasur infiltrime politike nuk po du mi përmendë, rregullorja e thotë kështu se nashta dikush nuk e ka lexu mirë: Mundësisht ti bëhet përfaqësimi i lagjeve në bazë të numrit të banorëve, nuk thotë domosdo mundësisht për shkak se ni lagje nuk do me marrë pjesë e nuk mund të pengohet procesi zgjedhor në atë fshatë. Edhe përfaqësimin gjinor e përmend mundësisht edhe këtë e përmendë për shkak se na duhet ta kemi të kuartë se ne kemi pasur qeft, me marrë pjesë edhe gjinia femërore por në atë fshatë është dashtë pakë me kanë

do tolerancë kur ka konkurs një femër është dashtë mu kënaqë edhe mja dhanë detyrën e kryetares mirëpo nuk kemi mëri në atë e nashta në të ardhmen do ta kemi konkurrencën me te fortë. Unë po e hedhi ne votim por tani rekomandim bjen te pagesa bjen prej kuvendit dhe hynë si rekomandim i kuvendit. Komisioni e ka rekomandu mëditjen ekuivalente në bazë të, qysh e merrë komiteti për politike dhe financa dhe nëse rritet me ju rrite edhe kryetarëve por ne këtë rast propozimi është fikse edhe të jetë mujore. Shkojna tash në votim i kena dy propozime: kush është që mëditja mujore për kryetar të fshatrave të jetë fikse prej 50 (pesëdhjetë) euro dhe të ju paguhet normalisht e jo mos me ju pagu. Kush është për? Me ngritje dore ju lutem? Pesë janë për. Shtatë janë kundër. Katër janë abstenim. Me pesë vota për, shtatë kundër dhe katër abstenime nuk kalon, atëherë mbetet propozimi i dytë. Atëherë kush është për propozimin e dytë që mëditja të jetë me pjesëmarrje në mbledhje dhe shuma të jetë 50 (pesëdhjetë) euro edhe kjo fikse të jetë. Kush është për, tash me ngritje dorës:

12 janë për, 5 kundër, 1 abstenim, kalon propozimi i dytë. Tash rekomandimi që ke për pagesë ajo bjenë tash shkojna i votojna edhe dy rekomandimet tjera me listën e kryeartëve të fshatrave dhe me listën e kryesive të fshatrave edhe inicimi i procedurave për plotësim ndryshimin e rregullores: kush është për? Tash është raporti, listat, edhe inicimi i rregullores .

20 për, kundër nuk ka, abstenim 1, aprovohet raporti i komisionit për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve nëpër vendbanimet e fshatrave të komunës së Malishevës faleminderit. Edhe një propozim është pagesë e komisioneve. Meqë është propozim unë du me hedhë në votim. Kërkesë e komisionit është që të paguhet të gjitha mëditjet në teren dhe në zyre kështu është kërkesa tyre ata kanë marrur vendim unë e kam përcjellë për kuvend është çështja e pagesave dhe arsyeshmëria e tyre është se ka pasur shpenzime unë tash po e hedh në votim propozimin e komisionit për pagesën e anëtarëve të komisionit edhe në teren edhe në zyre për pjesën tjetër që nuk janë pagu. Sa herë janë kanë të gjitha. Kush është për?

Për: 13

Kundër: 8

Abstenim: 0

Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Komunën e Malishevës për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018. Hapim debat rreth kësaj pike.

Hashim Vrenezi: Sa i përket raportit të auditorit që dy vite po më bjenë me lexu me vëmendje përmime është për mu qeshë ky raport te mënyra e qeverisjes që e kanë bërë, shumë është për mu qeshë çështje kyçe po filloj me pjesën e kontratave kontestuese të cilat prezantu kta në pasqyrat financiare te vitit 2018 e të cilat pritet kontraktorët mi realizu kontestet gjygjësore kjo shumë është 326 (treqind e njëzet e gjashtë)mijë euro të cilat ata nëse i fitojnë kontestet komunës do ti tërhiqen këto mjete edhe buxheti I komunës duhet të jetë në rrezik këtë e ka konstatu auditori. Kjo është faqe 8 (tetë) tek çështjet kyçe të auditimit dikund ka mesi paragrafit 3 (tretë). Te faqja 11(njëmbëdhjetë) Valon Konkluzioni për Menagjimin Financiar dhe Kontrolli. Planifikimi buxhetor dhe menagjimi i projekteve kapitale vazhdon edhe më tutje dhe kjo do te jetë sfidë për komunën tonë. Fushat kryesore ku përmirësimet janë: prokurimi publik, menagjimi i projekteve kapitale ku edhe ne kemi bërë vërejtjet tona në vazhdimësi këtu du mu nal pakë që projektet kapitale po na devijohen dhe njëkohësisht projektet tona po fillojnë mu punu dhe po lidhen kontratat akoma pa u bërë zotimi i mjeteve. Kjo është dobësi e qeverisjes Begaj dhe keqë menaxhim për shkak se këta së pari duhet me bërë projektin me paramasat duke e llogaritur duhet mu bërë zotimi i mjeteve e më pastaj mu bërë realizimi i projekteve sipas paramasave dhe parallogarive dhe mu monitoru. Kemi klasifikim të shpenzimeve të kodeve ekonomike se nuk po i ndanë zërat buxhetor edhe në këtë fushë ka bërë gjetje. Menagjim i personelit i dobët edhe menagjim i pasurive jo kapitale i dobët. Në faqe 15 (pesëdhjetë) procedurat e rekrutimit kjo është njëra

më së shumti ku është tu bërë qeverisja begaj politikë dhe as një person nuk mundet mu punësu pa u kanë anëtarë i nismës nuk realizohet punësimi. Këtu kemi disa prej problemeve që veç janë cekur në raportin e auditorit. Ata që kërkojnë për punësim ju detyrohet me dalë në fotografi e edhe kryetari Limaj ka pasur qef me dalë në fotografi me mu por ta siguroj që nuk mundet me dalë edhe për këtë jam shumë i bindur. Faqe 17(shtatëmbëdhjetë) marrëveshjet për shërbime të veçanta kjo është njëra ndër sfidat e komunës së Malishevës pikërisht këto të fotografive ku komuna i ka punësu 65(gjashtëdhjetë e pesë) punonjës me kontratë mbi vepër për shërbime të veçanta kur e dina se mbi gjashtë muaj nuk ka drejtë për specifika kur stafi nuk mundet mi krye për shkak se ato punë kanë specifika të veçanta këtu punësohen disa njerëz që më shumë e komplikojnë punën e stafit administrativ këtu dhe krijojnë tollovi sa që kryejnë një farë funksioni. Pesëdhjetë e tre prej tyre janë angazhuar edhe për herë të dytë. Për këta persona komuna nuk kanë llogaritur 5 % te ndaljes pagë tash komuna i pagunë edhe këto 5% nuk e ka parapa dhe nuk e ka dit që duhet mi pagu edhe kësaj kategorie. E ka dëmtu buxhetin tonë për kontributet e kësaj kategorie. Faqe 19 (nëntëmbëdhjetë) janë parregullsitë në procedurat e prokurimit. Parregullsi në procedurat të prokurimit ka shumë Auditori ka vërejt pak në raport me atë që kanë parregullsi procedurat e prokurimit në komunën tonë, këtu i ka specifiku me artikuj ushqimorë ku kemi i identifikuar plani i prokurimit për furnizime ishte vlerësuar 14,500 (katërmëdhjetë mijë e pesqindë) euro, ndërsa kontrata është nënshkruar, 68.857 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) euro që janë çështje të moskordinimit dhe mos harmonizimit të qëndrimeve. Faqe 20 është aprovimi i subvencioneve dhe pa shqyrtimin e kërkesave nga komisioni përkatës. D.m.th te pjesa e subvencioneve kryetari e ka nda ju ka aprovuar një kërkesë e një individit privat në shumë prej, 900 (nëntëqind) euro e cila e ka tejkalu limitin e rregullores të cilën aj ka drejtë me aprovu këtë kërkesë dhe nuk ka formu komision për aprovimin e kësaj kërkesë. Këso dukuri ka besoj shumë por auditori e ka cek vetëm këtë se besoj që aj nuk e auditon krejt fushën. Proceset e pa rregullta të prokurimit publik këtu auditori e ka specifiku shkollën e fshatit Panorë ku ishin zotuar 100 (njëqind mijë mijë) euro kurse me ligjin e vitit 2018 ishin ndarë 170 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) euro. Përderisa projeksionet e buxhetit ishin vlerësuar 420 (katërqind e njëzet mijë)euro për dy vite ndërsa kontrata me punëkryesin është nënshkru në vlerë 495 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) këto janë problemet e komunës sonë që nënshkruan kontrata më shumë se sa vlera e mjeteve që i ndanë dhe masanena ka konteste gjyqësorë me ata kontraktor edhe buxheti i komunës sonë po dëmtohet në këtë mënyrë.

Është kontrata e banimit social edhe këtu ka gjet parregullsi auditori, operatori ekonomik ka bërë disa ndryshime të certifikatave nuk ka prezantu dokumentacionet e duhura dhe në të njëjtën kohë është bërë nënshkrimi i kontratës që nuk ka të bëjë dhe nuk i ka plotësu kriteret sipas kërkesave të tenderimit që janë bërë. Parregullsi tjetër në faqen 23 (njëzet e tre) është pagesa e ndalesave prej 10 (dhjetë) përqindëshit Valoni e dinë mirë këtë fushë edhe këtu ka parregullsi të mdhaja për shkak se projekti kapital duhet mu finalizu dhe komisioni i pranimi teknik duhet me dalë komisioni me bë pranimin teknik edhe tek pas 12 (dymbëdhjetë) muajve këta duhet me bë një komision dhe me bë verifikimin e projektit edhe një herë dhe projekti tjetër diçka çka është sipas paramasave që janë cekur në tender e tek pastaj me bë pagesën e dhjetë përqindëshit. Kësi raste kemi mjaftë shume të cilat pagesat ju kanë bërë para kohe prej 12 muajsh. Edhe një çështje tjetër është mangësi të çështja e certifikatave këtu e kena një rast kur komuna ka bë marrëveshje me një OJQ dhe janë përcaktu për kushtet e marrëveshjes ne tri lëndë të certifikuara nga pagesa për 46.454 (katërdhjetë e gjashtë mijë e katërqind pesëdhjetë e katër) euro në projektin për kujdesi shëndetësore shtëpiake mungojnë raportet nga organi mbikëqyrës i komunës si lista e pagave dëshmitë e shpenzimit të telefonit provizionet bankare edhe raportet tjera tre mujore. Kjo nënkupton që këta me këtë OJQ është dashtë me pas një raport se ku i kanë shpenzu ato OJQ këto pare 46.454(katërdhjetë e gjashtë mijë e katërqind pesëdhjetë e katër) euro dhe mi arsytu këto mjete. Kta nuk i kanë arsyetu ja kanë dhanë mjetet edhe sigurisht që kjo është se prapa sajna duhet të fshihet diçka. Se këtu në qeverisjen begaj asgjë nuk ndodh rastësisht por gjithçka është e planifikume mirë edhe çdo detaj është i planifikum dhe e ka qëllimin gjithmonë qatë 10 % përqindëshin me mshef pak. Parregullsi në pranimin e punimeve dhe monitorimin e kontratave. Me të than drejtën çdo investim kapital që është krye në komunën tonë jam i sigurt edhe këtë e them me përgjegjësi të plotë edhe

publike secilën mujna me dake me verifiku çdo projekt kapital që është krye në komunën e Malishevës e thamë me përgjegjësi dhe garantoj që nuk është krye në bazë të paramasave dhe përlllogarive. Komuna e bënë verifikimin e vetëm disa prej tyre dhe ka gjetur shumë parregullsi ka specifiku shkollën fillore Afrim Krasniqi në fshatin bardhë. Shkollën fillore Afrim Buqaj në Lladroc aty janë zhvendos dyert jo të paramasave të kërkuara por janë vendosur më të vogla. Në tjetrën shkollë ka pasur mu vendos interneti dhe nuk është vendosur fare edhe kërkuar nuk është përgjigjur për këto kjo është arsyeja e atina 10 përqindëshit Valon që nuk duhet me ja dhënë por duhet me pritë mja dhanë pak ma vonë. Kena pa rregullsi në pranimin e faturave ku ktu janë bë një herë vinë edhe dy fatura me numër të protokollit te njëjtë me numër të njëjtë edhe bëhet pagesa e atyne faturave pavarësisht vlerave të ndryshme pse ndodhë kjo nashta mundet me na spjegu Valoni pak ma mirë. Është rasti te fshati Mleqan kanalizimi 10.896(dhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) euro ku i kini pranë dy fatura njëra me vlerë 12.891(dymbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë) euro dhe është paguar dhe tjetrën faturë 21,380.94 (njëzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë euro e nëntëdhjetë katër centë) i njëjti numër i faturës dhe është aprovuar nga menagjeri i kontratës. Kjo ka ndodhur si rezultat i dobët i menagjimit të kontratës, nuk ka ndodhur rastësisht as kjo. Menagjimi i dobët i kontratave dhe vonesave në realizimi i tyre, këtu i kena dikund 12 (dymbëdhjetë) kontrata i kanë specifiku këta të cilën kontraktorët kanë vonesa dhe komuna nuk e ka aplikuar as një masë të penaltetit për vonesën e kryerjes së punimeve si në investime si në kryerjen e investimeve kapitale në furnizime dhe të tjera. I kemi dy raste ku është bërë pranimi i kësaj nga menagjeri i kontratës dhe pa ndonjë komision të pranimit e cila është edhe kjo e pa ligjshme. Pagesa për vendime gjyqësore dhe të përmbarimit buxheti i komunës tonë është dëmtuar për 122(njëqind e njëzet e dy mijë) euro, 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetë euro) për vendimet gjyqësore shpenzimet shtesë në emër të interesit të shpenzimeve gjyqësore për vetëm 7 mostra te testuara d.m.th kanë qenë 11 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy euro) edhe këto janë për shkak te këtyre kontesteve që komuna e jonë nuk bën planifikimin në harmoni me procedurat e rregullta të tenderimeve. Ne e bëjna një buxhetim dhe këta thojnë nuk na kanë mjaftu mjetet. Qysh nuk kanë mjaftu mjetet njëherë duhet mu bë zotimi i mjeteve tani me vazhdu procedurat tjera, nëse nuk ki mjete të mjaftueshme nuk e bënë tenderin hiqë e pretë. Planifikim jo i duhur dhe keqë klasifikim i shpenzimeve në kodet ekonomike, kjo është fushë Valon që të përket konkretisht ty nuk është dashtë mi bë këto keqë klasifikime ekonomike vlera e tyre është 456 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), kjo është e qëllimshme ose nëse nuk është e qëllimshme për diçka jo profesionale nuk po di çka me qujtë tjetër për derisa ekzistojnë kodet ekonomike. Është edhe kjo fushë e caktume obligimet kontraktuale pa zotim të mjaftueshëm dhe urdhërblere me vonesë d.m.th i ka specifiku auditori këto raste janë 15(pesëmbëdhjetë) mostra te cilat i ka marrë në të gjitha ka pas probleme. Gjetjet e auditorit për mu janë kanë shumë të vogla në raport me at se në jetën e përditshme. Unë nuk e di se cili është një projekt kapital i cili është krye në harmoni me paramasat dhe parallogaritë.

Sadije Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë, e kamë lexu këtë raport dhe këtë raport mjaftë voluminoz dhe në këtë raport auditori jep një opinion të pa modifikuar për pasqyrat financiare ku thotë që pasqyrat financiare vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe në të gjitha aspektet materiale. Gjithashtu auditori në këtë raport jep një konkluzion për buxhetin ose për shpenzimin e buxhetit ku thot komuna e Malishevës rreth 98 % (nëntëdhjetë e tetë përqindë) e ka shpenzuar buxhetin e vetë për vitin 2018 dhe është një realizimi i mirë në përgjithësi ndërkaq duhet shiquar këtë raport vërejtjet apo sugjerimet e auditorit për të gjeturat sigurisht se ato duhet të përmirësohen dhe nuk mund te them se gjithçka shkëlqen në këtë raport dhe mund të them se pjesa e rekomandimeve është mjaftë e rëndësishme edhe por prokurimin administratën edhe për te gjitha shpenzimet e parasë publike dhe menagjimin e projekteve pra duhet te të punohet shumë që këto rekomandime të zbatohen, unë pajtohem me të gjitha të gjeturat e këtij auditimi mirpo nuk muj mu pajtu me parafolësin tim që thotë që këto gjetjet e auditorit janë shumë të vogla në krahasim me gjendjen. Pajtohem me të gjeturat e

auditorit por nuk pajtohem me komentin tënd koleg asamblastë që duhet mu fotografu një herë me kryetarin mandej me siguru një vend të punës.

Sylë Dukolli: Une veç po e filloj me një fjali kështu që të gjithë e keni parë raportin e vitit 2018 për vitin 2017 me ato që i ka gjet auditori është raport ma i mirë se sa i vitit të kaluar kurrë pa u kënaqë me ato që janë arritur por duke e përmirësuar veten në bazë të këshillave dhe rekomandimeve që jepen këtu. I përcjella parafolësit e mi unë besoj që ka vlerë edhe shpenzimi i buxhetit siç tha edhe kolegii 98 % dhe është diçka e mirë në atë aspektin jo pse nuk jesin mjetet pa u shpenzë por faktikisht na e dina që disa komuna vetëm e bartin dhe nuk mujnë me shpenzu buxhetin, në këtë rast edhe kryeqendra e republikës sonë. Ky raport i auditorit mundë të jetë edhe publik dhe të lexohet është i pa modifikuar dhe unë mendoj që ato të gjetura që i ka gjetur auditori duhet të jenë alarm në aspektin rregullimit të kontrollit të mbredshëm nga ana e ekzekutivit. Ndërsa për anën e mbredshme në anën tjetër që është punu shihet. Të gjitha ato të gjetura edhe për punësimet sezonale është debatë gjithë vitin dhe nuk është diçka e re që auditori ka gjet. Tash unë duhet mi besu raportit se ato që i kemi ditur i ka qitë por edhe ato që nuk i kemi ditur i ka qitë janë krye pune të mira edhe këtu duhet ti besojna se është raport publik. Mjetet e bartura që tha parafolësi mund të paraqet rrezik, kjo gjendje na përcjellë qe sa kohë. Mirëpo është e vërtetë se janë ulë borgjet, nëse e ke lexu krejt raportin besoj që po ka ulje të borgjeve publike të komunës. Te keqë menagjimi i kontratave e di që e kamë thënë vazhdoj me thënë dhe do ta them gjithë, uroj që ti menagjojnë projektet kontratat ma mirë. Arsyeja është se vetëm aty shihet produkti final i një punës së një operatori që paguhet me pare publike. Te ato shkeljet e vogla që po i shohim parregullsitë e menagjimit te rekrutimi dhe te ndarja e mjeteve që paska qenë një shkelje e kryetarit. Unë e përgëzoj veç për një shkelje të tillë edhe pse edhe kjo ka mujtë mu menaxhu me i pas dhënë kohë qysh e ka bërë shpërndarjen me të drejtë qysh e ka deri në 500 (pesëqind) euro. Mirëpo sigurisht nuk ka pritë rasti dhe kryetari në atë aspektin siç e dina që është humanitarë i ka grah veç për punë të humanizmit, mirpo auditori edhe këtë e gjenë si shkelje. Ne sot po flasim për punësim që folëm në anën tjetër për mu duhet të merret nga ekzekutivi si rekomandim thjeshtë çështja e menaxhimit të dokumenteve manipulative, unë i quaj kusht dokumentet administrative thotë p.sh personeli përveç kopjes fizike duhet ta ruaj dokumentacionin edhe në mënyrën elektronike. Është një siguri e ruajtjes së dokumentacionit prandaj thotë duhet të ketë edhe renditje kështu që për arkivin apo burimet njerëzore edhe pse në anën tjetër i arsyeton burimet njerëzore. Ne po flasim me mbipunësim se aj i arsyeton ne aspektin që ka numër te vogël të stafit nëse e keni pa. Unë mendoj që këtu duhet me pa që arsyetohet se është administrata dhe personelit të kuvendit Komunal. Unë te rekomandimet në bazë të cilave e kamë pa, del që shumica janë të zbatuara një pjesë janë në proces dhe një numër ma i vogël nuk janë të zbatuara ose presin në zbatim. Te rekomandimet e viti të kaluar aty e ulë ose e ngritë niveli përgjegjësisë së kontrollit në ekzekutiv. Te investimet Kapitale e kamë pa që një pjesë e mjeteve është bartë nga mallrat dhe shërbimet dhe është normale në atë kuptimin që ma shumë drejtohen në projekte kapitale se sa të bahen shpenzime të përditshme të cilat ndodhin në komunë. Në përgjithësi mendova veç me i thanë disa që i kamë bërë me shenjë, e kamë pasur një raport të mirëfilltë, nuk e kamë këtu e kamë pasur për secilin kapitull që e ka paraqitur auditori dhe besoni që të gjitha janë nuk kemi se çka mi shtue. Për mendimin temë është raport ma i mirë se i vitit nëse pajtoheni nëse nuk pajtoheni mundeni me lexu raportin e vitit të kaluar dikund për nja 20 deri në 30 % rritja e kontrollit dhe përgjegjësisë ne këtë raport të paktën auditori ato që i ka pa, se na e dimë që aj tha se aj e ka formën e vetë të auditimit. Po flas me Hashimin në këtë rast, Hashim nuk kish lanë sen pa pa sikur me pas punu ju opozita por megjithatë nuk kish dalë keqë si raport. Nuk po më kënaqë kam qeft me qenë ma mirë.

Alban Krasniqi: Këtij kuvendi ka fillu mi hupë rëndësia e debatit vendimmarrjes për dy arsye: arsyeja e parë dhe kryesore është mungesa e kryetarit dhe e drejtorëve kur diskutohen çështje më të rëndësishme. A ka dokument më të rëndësishëm se sa kur diskutohet për buxhetin dhe raportin e auditorit nuk besoj që ka. Rendi i ditës ka ardhë me kohë dhe janë kanë të njoftuar të gjithë kryetari ishte një kohë këtu edhe aj doli iku, e kena drejtorin këtu si çdo herë. Unë pajtona me nënkryetarin se

ne duhet me fillu me bë një praktikë që punët e kryetarit dhe përgjegjësitë e kryetarit mos të delegohen aty ku nuk e lejon ligji. Për këtë raport të auditimit nuk ka se çka del me fol drejtori realisht. Ky raport ju ka dorëzuar dy institucioneve të rëndësishme kryetarit edhe kryesuesit edhe normal që drejtorët kishin mujtë me dalë me lejen e kryetarit, një fakt që dihet në vazhdimësi por që jemi duke e shkelur anashkalu ma mirë me thanë tujë i pa rrethanat. Unë mendoj që raporti ma i mirë pasqyra më e mirë e asaj se qysh qeveriset komuna është prezenca ose mos prezenca e kryetarit edhe e kabinetit të tij. Është në të njëjtën kohë edhe interesimi i asamblistëve për këtë temë. Mungesa me e madhe dhe dëgjimi se ka diskutojnë për raportin kallëzon shumë. Uroj që qytetarët ti shohin këto dhe ti vlerësojnë këto dhe në zgjedhjet e ardhshme të dihet se çfarë asambleista vinë. Ndoshta e mbërrin majën kjo punë se dikush vjenë këtu për me fletë e mos me bë bash senë. Unë deri dikund i kuptoj kta të pozitës për shkak se si deputet nashta mun edhe ma letë me dalë ose si asamblistë. Janë 100 (njëqind) rrethana tjera që ta pamundësojnë me dalë në kundërshtim të diçkafit ose kritikë por ju inkurajoj që me marrë guxim me dalë nëse jo për ata me dalë për senet tjera. Njëra prej asambleistëve para folësë e përmendi çështjen e fotografive në kuptimin e asaj që nuk ka pa rregullsi në këto procese kur bahet rekrutimi dhe çuditërisht çështja e dytë e rekrutimit e auditorit flitet edhe ta keni parasysh a dini se auditori çka auditon se aj se ka auditu procesin se qysh janë marrur qata njerëz në punë. Auditori ka hasë dokumentet pra çka ka gjete prej dokumenteve çato i ka analizu dhe në baze të analizës së dokumenteve se çka ka gjete aje ka auditu i ka gjet parregullsitë ja bëni ju plus qeto çështje që po i ngrisim na çdo ditë se çka është tujë ndodhë. Para tri katër ditësh nuk ka ma shumë ishte një konkurs ishte duke u bërë intervista për qendrën për punë sociale edhe krejt e dishin se në këtë pozicion tashmë është përcaktuar një vajzë që nuk po ja përmendi emrin që është prej fshatit Gurbardhë edhe ta shohim tash na a po zgjidhet qajo vajzë apo jo. Para pak kohësh ju kam thënë se ka mu zgjedh një R. H. nga fshati Bellanicë. Dy janë kanë me 5 vjet edhe masterin e kanë krye dhe ky me tri vjeçarë edhe mërrinë e ky ka fotografi e ky ka me krejt fotografi aktualisht me kontratë por para se me pas kontratë ka mbikëqyrë dhjetëra projekte të komunës të pranueshme. Nuk ka të drejtë me kanë mbikëqyrës punimesh një njeri me kontratë mbi vepër dhe aj është mbikëqyrës dhe aj ka fotografi. Rasti tjetër është djali i ish kryesuesit të cilin inspektorati e kthej si rast dhe tash kanë arritë e kanë marrë një krejt të komunës tjetër s'ka lidhje që është i komunës tjetër por vjen prej nismës. Këqyr çka kanë nisma kur nuk gjene këtu nuk këqyr me marrë këtu por e gjanë një të nismës në komunën tjetër. Ama ti shqiptar po por nuk je me nismën sikur koha e ish regjimit të Jugosllavisë që ndodhë në praktikë. Kur dush rastin e fundit edhe qito tri raste me kompetencë shkojnë i këqyrëm edhe të bindemi se nuk po ja huqin duke i shkelur njerëzit. Edhe një prej rasteve është raporti i auditorit pikërisht një prej aktivistëve të lëvizjes vetëvendosje ku ka ndodh ky proces i rekrutimit ka qenë në muajin e pesë gjashtë të shtatzenisë edhe a kanë tujë e hupë beben për shkak të presioneve që ja ka sjellë Ragipi edhe ata tjerët edhe e keni ne gjetje të auditorit që aj proces i ka pas parregullsitë edhe me letra nuk kanë mujtë me mbulu. E pa letra dihet se çka ka ndodhë ju kanë dhanë pyetjet e gatuar se qysh mu përgjegjë se janë tujë ju dhënë edhe tash. D.m.th. Sylën du me marrë në punë ja jap pyetjet paraprake dhe intervistën edhe jam në gjendje si me thanë muj me hy garantë. Hapi ti dokumentat ti këqyrim sot qatëherë ta dëshmoj për cilin dush, ama unë nuk muj me dëshmu përveçqë fjalës edhe besimit edhe besimt të tjerëve që edhe mos harroni që shumë prej informacioneve na vinë prej vetë njerëzve që janë të nismës nga një herë që ta keni parasysh sepse disa prej tyre nuk i durojnë do shkelje që janë duke i bërë. Unë veç po i thamë disa prej shkeljeve që janë gjete. Testi me shkrim te ky rast i Qendrës për Punë Sociale testi me shkrim thotë nuk është nënshkruar nga kandidati, raporti final i rekomandimit nga komisioni nuk është plotësuar si duhet, mungojnë informata rreth kandidatëve rreth procesit të rekrutimit. Syl çka d.m.th. çikjo nuk ka informacione që qysh ka ndodhë procesi i rekrutimit edhe kandidatët kush kanë aplikuar. Dikush i ka shti duart që e ka zgjedh qatë djalë, qaj tipi që a zgjedhë në qit proces të manipuluar tash aj është në panel me zgjidh atë tjetrin por këtë nuk e kanë kërkuar. Unë nuk e di i falënderoj për durimin krejt ata njerëz që aplikojnë sot, për besë me ndodh mu qysh ju ndodh atyre unë nuk e di se ku kisha përfunduar me qatë panel dhe me Ragip Begajn edhe me drejtorin dhe me secilin njeri. Unë nuk e di se ku kisha përfunduar për vete po thamë. Nuk aplikoj dhe as nuk konkurroj mu kanë 50 (pesëdhjetë) mijë euro rroga se nuk du me hi aty ku nuk hihet, e këta të shtinë

qaty. Rezultati i konkursit nuk është aplikuar ne ueb faqen e komunës dhe kontrata e punës është nënshkruar brenda 5 (pesë) ditëve pa kaluar afati 15 ditorë i ankesave. Por çka po doni me thënë ma shumë raporti i auditorit në detaje se qysh punësohet një njeri në vitin 2018-2019, 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet) vite pas luftës në një qeveri që nuk hin era shqiptarë këtu. Këtu vjen era krim korrupsion, këtu vjen era shkelje e dinjitetit, shkelje e të drejtave. Qitë po e them që e ka thanë auditori, e ti po më thu Sylë mirë, a është mirë qikjo Sylë, çka lexon prej qisaj. Prej qisaj lexon që ka qenë proces i manipulium, ka pasur shkelje flagrante, e njëjta ndodhë me mësimdhënësit. Prapë edhe këtu thotë nuk kishte një norme të paracaktuar të vlerësimit kandidatëve nga komisioni për mësues është fjala. Pra merre me menë na kemi ende shkelje s'ka norma se si bëhet vlerësimi. Merre me menë tash sa mësuesit i kena pranë qe sa kohë nisma është në pushtet sa mësues kokan pranë. Athu qashtu apo edhe ma zi se qashtu i kanë pranë. Në formularin përmbledhës në disa raste mungonin informata të nevojshme rreth pikëve të kandidatëve. Mungonte edhe nënshkrimi i njërit prej anëtarëve të komisionit. Si rezultat komuna kishte pranuar edhe një punonjës po thotë nga një listë e kandidatëve pjesëmarrës, ndonëse konkursi fillimisht ishte hapur vetëm për një pozitë. A jini ka kuptoni a hap për një pozitë e kanë marrë edhe një tjetër prej qasaj liste, dy veta i kanë marrur. Prapë janë nënshkru kontratat pa e pritë afatin me përfund. Pra veç kjo pjesa e punësimit e tregon se në çfarë gjendje jemi, kjo është gjendja fatkeqësisht edhe kjo është brenga jeme ma e madhe sepse demotivon një njeri e shkel që e merr në punë ja ke shkelë dinjitetin, dhjetëra të tjerë ju ke hupë shpresat se në këtë vend bahet mirë. A me pritë me ra njerëzit në konopë a ? Jo na nuk duhet me pritë por duhet me reagu. E deri sa nuk ka reagim këta kanë me vazhdu qishtu. Për marrëveshjet e shërbimeve të veçanta i tha edhe parafolësit kontrata të pa numërta. Kontratë në vepër tash ma edhe te bërlloku edhe te ujësjellësi kanë qu njerëz qoftë me kontrata të ministrisë. Është keqpërdorim flagrant i buxhetit edhe shkelje flagrante të procedurave që duhet mu bë. Është tujë ndodhë ky proces i kini marrë prej Carrallukës dy vetë kini shku i kini ble ju kanë thanë na ju shtina me punu në bërllok ose duhet me punu atje. Pse nuk e hapni konkursin edhe për kontratë në vepër. Konkurs le të aplikojnë njerëzit me një civi të thjeshtë, masanej me procedurat e thjeshta e zgjedhë njerin. Nuk është tujë ndodhë ki njerëz me kontrata me ka dy tri vjet. Ki njeri ne drejtorinë e kulturës që është tujë e kry funksionin aktualisht krejt detyrat e përshkrune i ka që i kryen zyrtari për rini. Zyrtarin për rini e kanë qitë në aut dhe e kanë marrë kit tipin dhe ja kryenë atina. Çka jini tujë bë veç që nuk është aj zyrtari i rinisë me nismën a dhe ati mja bë punën që me dalë. Ky është rezultati, auditori nuk e dinë këtë punë, nuk e dinë qysh ka ardhë Amrush Elshani. Unë pe di qysh ka ardhë se pe shohë procesin. Po e shoh në dokumente që i kena marrë se qysh ka ardhë edhe çka është tujë ndodhë, edhe sa këso raste qashtu i ki. Aj Ramizi është rasti tjetër e rastet tjera të kontratave në vepër. Me çfarë kriteri i kini marrë? Me çfarë kriteri ka ardhë Ramizi në kontratë në vepër cili është kriteri? Fotografia një dhe diçka tjetër mos harroni ta qojna aty ku mujna me mbulu krimin dhe korrupsionin edhe krejt rastet që kanë të bëjnë me kualitetin e dobët të punimeve janë këta njerëz që e mbikëqyrin. Shumica e njerëzve që i mbikëqyrin këto janë në kontrata në vepër. Këqyrni e keni rastin e inkubatorit, kush është përgjegjësi për kit mbikëqyrje të sajë. E kur ka ndodhë ajo a kanë ky, para se mu zgjedhë edhe e gjani se qysh një njeri në kontratë në vepër. Këto i ka gjet auditori por auditori nuk e dinë qitë rast se aj nuk shkon nuk shkapuritë ma shumë atje. Për pjesën e procesit të prokurimit mbreda ato 10 (dhjetë) përqindëshat është një arsyetim kështu koti. Na e dina që 10 % është obligativ dhe lema ti mue sigurinë bankare ti e ki obligim, sa kush qe 10 (dhjetë) vjet a fol investimet e dobëta dhe cili është dashtë mu kanë reflektimi i komunës. Mirë investimet e dobëta i kanë dy hapa që mujna mi bë, mbikëqyrje ma radikale ma kualitative ma të ashpër edhe kufizime në kuptimin e pagesave. Tujë i mbikëqyr tujë ja dhënë ose mos me ja dhënë paret edhe në fund të procesit për me rritë sigurinë që cilësia është më e mirë edhe që nuk ka najë prishje edhe pas afatit kur e përfundon punën ti e man qatë 10 (dhjetë) përqindëshin se kjo qasje dorëshlire e komunës që paska ardhë dikush me një garantë me fletë garantuese dhe bankare dhe ti ja jep 10 (dhjetë) përqindëshin, jepja paret e babës tënd por jo paret e tona. Me çaçë lehtësi jepja paret dhe a ja ke dhanë najë kujna paret që e ka krye menjëherë. Por ti ne shpi kur e maron shpinë qatë qasje duhet me përdorë. Këtu veç jep se gjysma e firmave që ju kanë dhënë, ne ti binë me listë që nuk dalin që janë kompani të lidhura me nismën na flasim edhe me ta

masanejë. Na ju argumentojmë edhe të kundërt certifikimit të pagesave, drejtori i shëndetësisë është këtu. Këtu ka me projektin e Handikosit 46,545.04 (katërdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e katërdhjetë e pesë pikë katër) euro është, Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake këtu auditori ti ka gjet që mungojnë raportet nga organi. Ngoje drejtor për ty është kjo, më së pari mue nuk mi ke dorëzuar që ti kamë lypë e ki që një vjet nuk ma ke prurë as listën e punëtorëve as një sen nuk ma ke prurë. Mue jo. Nënkrjetari është këtu dhe thotë me bë kërkesa zyrtarisht ti edhe sot e kësaj dite mu përgjigj me buxhet dhe sa është buxheti dhe sa është numri kontratën e vjetshit se ka janë shkuar ato paratash auditori ta ka qitë të paratash këtu se po thotë mungonin raportet nga organi mbikëqyrës i komunës. Lista e pagave dëshmitë e shpenzimeve telefonit, provizionet bankare, raportet tre mujore kjo ka ndodhë si rezultat i kontroleve jo adekuatë në certifikim e pagesave. Për të ka në parregullsinë e pranimit të punimeve ku auditori ka gjet disa shkelje sipërfaqësore edhe unë jam mësë i sigurt që ndërtimi i shkollës fillore Agim Krasniqi po edhe i shkollës në Lladroc përcillet me shkelje sidomos i kësaj në Lladroc flagrante dhe po e jap vetëm një shembull në shkollën e Lladrocit në kohën kur është bërë projekti për ndërtimin e shkollës dhe ka filluar zbatimin i punimeve në të njëjtën kohë kanë ndodhë dy zotime shtesë: njëra ka qenë kontrata brenda dhjetë përqindëshit që e parashihet punën shtesë dhe tjetra a kanë dikund me vlerë 20 (njëzet mijë) euro në emër të renovimit të shkollës së vjetër. Paret iu ka hanger dikush le të na binë të kundërtën i ki zotimet edhe drejtori, është nënkryetari argumentoma të kundërtën dhe na dalim dhe ju thojna ju lumtë paskam gabu. A muni qito shqetësime të faktume për mendimin tonë se po thu që nuk janë krye punët me na argumentu ju ndryshe. Deri sa nuk i argumentoni unë mendoj që këtu shkeljet jo që ka por edhe vazhdojnë. Për mu kthye të parafolësi që tha që ka ndryshime dhe përmirësime janë rrafsh 23 (njëzet e tre) rekomandime të vitit 2018 që sa gjysma e atyre të më hershme nuk janë plotësuar. Trembëdhjetë i ki të kalume të pa krye edhe nuk janë të pa rëndësishme ato. Trembëdhjetë, 23 (njëzet e tre) Sylë nuk janë adresuar dhe për fund po e shfrytëzoj rastin me bë publike diçka që është bërë edhe më herët se nuk kemi mujt me bë se sa qikë raport edhe qikë që e kemi qu flasim edhe janë në përputhje është edhe rekomandimi që ka nxjerrë kuvendi edhe përmes atij rekomandimi që ne pastaj një grup i asambleistëve e kemi qu rastin në polici. Unë, Albani edhe Valoni mbi shkeljet keqpërdorimin vlera e mjeteve të cilat janë në shpërputhje d.m.th raporti që na ka ardhë financiar i 2018 i cili ka ardhë, me atë se kanalizimi në lagjen e re 58 (pesëdhjetë etetë)mijë euro a realizu 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) përqindë, kanalizimi në rrugën Mulla Selimi në Marali 14(katërmbëdhjetë) mijë euro a realizu 98 %, ndërtimi i rrugës periferike minitransiti në Malishevë 49.3000 (katërqind e nëntëdhjetë e tre) mijë euro është realizu 98 % rregullimi i shtrati të lumit Mirusha nga ura e madhe në drejtim të mini transitit pra teposhtë anej 29.8000(dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë)euro, është realizu 96 %. Rruga rregullimi dhe mirëmbajtja e palestrës dhe stadiumit të futbollit 60.000 (gjatëdhjetë mijë) euro a realizu po ashtu dikund 95 % shkolla fillore që a ndërtu 170.000(njëqind e shtatëdhjetë)mijë euro, aneksi 98 %, ndërtimi i fushës në Berishë Burim dhe Shkozë 98.000 (nëntëdhjetë e tetë) mijë euro kanë figurë e janë të krye. Shërbimet tjera kontraktuese 348(treqind e katërdhjetë e tetë) mijë euro që na nuk i kemi ditë as ka janë edhe ka kanë shkuar ato mjete krejt këto rrokin shifrën prej 1.200000(një milion e dyqind mijë) euro e qito punimet infrastrukturore që i përmenda unë as njëra nuk ka ndodhë në raportin që na ka dërguar kryetari përmes drejtorit kanë figurë të gjitha të krye dhe ky raport i vërtetë i asaj se çka është punu edhe si është punu. Unë për fund kryesues unë mendoj që këtë raport kusht qysh është a i mangët qysh është zbutës në maximum ta analizojmë edhe unë menoj pse jo ky raport me të gjeturat mja qu ose prokurorisë ose policisë se ka shkelje. Po e zëmë në mënyrën është kry pika dy se nuk po hi ma felle kur thotë qysh janë pranë do njerëz në punë që mungojnë dokumentet përkatëse për mue është e mjaftueshme që me qu edhe mi këqyr edhe krejt me i hi rend kontratave të punës por edhe pikat tjera që i përmendëm 10 % përqindëshi rregullimet e ndryshme që janë bërë nëpër shkolla. Kjo shkolla e Lladrocit që nuk a përfshi aty ka kanë shkuar këto mjete e që janë dhanë mjetet për aneksin e të gjitha këto mu kanë objekt edhe me shkuar në këtë rast si kuvend. Edhe ti kryesues ja qon me ni letër përcjellëse i thush këqyre qit raport të gjeturat e auditorit dhe nëse ata vërejnë diçka në ta përcjellin ma anej ose nëse është në rregull atëherë na i marrim masat tjera dhe e qojna në prokurori vetë.

Hidajete Mazreku: Faleminderit kryesues unë i ndegjova parafolësit edhe nga shtjellimi që i kamë bërë këtij raporti drejt me thënë mue më doket që auditori i përgjithshëm çaçë ka gjete shkelje të thjeshta shumë të thjeshta edhe i ka marrë në shqyrtim të tyre, për kit arsye mue po më befason që ne po i përsëritim gabimet që tha Sylva sivjet jemi ma mirë, jo bre mue me doken do gjëra shumë të thjeshta nuk janë përmirësuar. P.sh tek theksimi i çështjeve shpenzimet prej 91,461(nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një) euro për paga dhe mëditje, mallrat dhe shërbimeve subvencione janë paguar nga investimet kapitale. Pse mu pagu nga investimet kapitale për shkak të këtyre buxhetimeve pagesat në vlerë prej 260,132(dyqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e dy) euro nga kategoritë e investimeve kapitale ishin bërë mallrat dhe shërbimet dhe subvencione, nga kjo rezulton se çështja e pasqyrimin të dobësisë në kontrollimin e tyre për të konfirmuar vlerësimin e regjistrimit dhe shpalosjen e saktë të pasurive. Edhe pse në kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë detektive në disa fusha janë dobësi eventuale, janë vërejtur në disa sisteme të rëndësishme financiare tek prokurimi tek menagjimi i kontratave mbi punësimin, tek klasifikimi i shpenzimeve, menagjimi i personelit, llogarive të arkëtuara dhe në menagjimin e pasurisë së komunës. Përgjegjësia ndaj rekomandimeve në vitin paraprakë nuk është adresuar ashtu si kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës. Angazhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënie në menaxhimin e rrezikut dhe raportit të mbredshëm janë të dobët. Pse duhet me qenë këto të dobët Valon? Auditimi i mbredshëm nuk ka mbështetur aq sa duhet zhvillimin në këto fusha edhe pse e kemi auditimin e mbredshëm dhe është i përbërë prej dy anëtarëve dhe ka kriju edhe komitetin, mirëpo neve po na përsëriten prapë të njëjtat shkelje të njëjtat veprime jo që janë adekuatë për sistemin financiarë. Tek çështja kyçe e auditimit që tha edhe Hashimi aty komuna në Malishevës për gjendjen e llogarive të anketueshme dhe taksave në biznese prej 821.340 (tetëqind e njëzet e një mijë e treqind e katëdhjetë) euro në këtë llogari borxhet që i ka. Mirëpo këto borxhe janë përfshi prej vitit 2000 (dy mijë) që i ka, ajo këto borxh e nuk mundet ti arkëtoj ti mbledh këto borxhe edhe pse angazhohet në këto borxhe ajo prapë mundet p.sh të hyjë në borxhet tjera ku do të vjen deri te bankrotimi i komunës dhe deri te shkatërrimi i ardhshëm i sistemit në vështirësinë e buxhetit. Sa i përket që kemi tek rekrutimi folën parafolësit e mi ju e dini këtu auditori ka gjete parregullsi, duke u nisur tek kontratat e veçanta, ku p.sh kemi pasur edhe nga parafolësit që shërbime të veçanta që janë bërë, janë bërë edhe shkelje të ndryshme. Buxheti total është rritur për 64.584 (gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e nëntë) mijë euro, kjo është ndikuar nga të hyrat e bartura në vlerë 11 (njëmbëdhjetë mijë e katërdhjetë e tre) euro financimi nga huamarrja në vlerë prej 3.388 (tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) euro në vlerë, nga donacionet 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) euro dhe 50 (pesëdhjetë) mijë buxheti nga qeveria. Shërbimet komunale këtu buxheti final është rritë për 50 (pesëdhjetë) mijë euro arsyetimet e rritjes së hapësirave të reja shkollore dhe shlyerjes së buxhetit nga viti paraprakë. Investimet kapitale në krahasim me buxhetin fillestarë buxheti final është rritur për 272.808 (dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetë) euro rritjes është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë prej 78.242 (shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e katërdhjetë e dy) euro donacione, 71.0037 (shtatëdhjetë e një mijë e tridhjetë e shtatë) euro financimi nga huamarrja 15 (pesëmbëdhjetë) mijë dhe 100 (njëqind mijë) nga aprovimi i qeverisë. Tek punësimi aty p.sh janë bërë shkelje të ndryshme si në shkolla ashtu edhe në administratë ashtu edhe në shërbimet shëndetësore dhe të mirëqenies sociale. Këtu e ceken edhe parafolësit këtu ka qenë edhe menaxhimi i dobët i zyrës së personelit. Çikjo mu po më vjenë çudi qysh me pas dosjet menaxhimi i dobët me qenë, për qitë unë po thamë se auditori kur dosjen e personelit nuk e kanë si duhet ku me fol ma anena. Te prokurimi e kemi p.sh të furnizimi me artikuj ushqimorë, plani i prokurimit i është vlerësuar 14.500 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind) euro, ndërsa kontrata është nënshkruar me vlerë prej 68.857 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë euro) euro po ashtu janë zotuar vetëm 5000 (pesë) mijë euro. Përderisa siguria e ekzekutimit nuk mbulonte atë periudhën 30 (tridhjetë) ditore për përfundimin e kontratës, ashtu edhe këtu i ki 10 (dhjetë) kontrata të gjitha i ke bërë në muajin dhjetorë. E kije të shkolla në fshatin Drenoc e kije tek përfshirja e njëjtë të përfshirja e zyrtareve tek ndarja e detyrave i ke detyrat kualifikuese nuk janë të përshkrume mes dy anëtarëve të njëjtë p.sh, që i kanë. I ki edhe pa rregullsitë e prokurimit publik i folën edhe këta për

shkollën e fshatit Panorc edhe kontratën e furnizimit të autoambulancës. E dini ofertuesi që ka ofruar, nuk ka ofruar specifikat në dosje të tenderit katalogut të automjetit as nuk është ofruar dhe as nuk keni kërkuar. Nuk është caktuar menaxheri i kontratës dhe nuk është pregaditur plani për menagjimin e kontratës. Pse kjo shkelje? Përgjigja e situacioneve ju e dini se situacionet gjithmonë qiten për shkak të përmbushës së kontratës, me situacione të keqe të sigurisë 60 % të defekteve të ndryshme që janë në kontratë. Situacionet janë të nevojshme shumë tek prokurimi. P.sh, tek fermat e ofertuesit me pas shkollën e lartë të serave as nuk e ka e ka vetëm certifikatën. Po du me thanë që në shumicën e rasteve auditori vetëm i ka ardhë keq prej neve që jemi qitu këto gjëra krejt të thjeshta i ka marrë që është duhet të përmirësohet. Rekomandime do jeni duke i zbatuar, do janë në zbatim e sipër.

Halil Morina: Na këtu po diskutoj na për një dokument i cili është shumë i rëndësishëm për Komunitetin tonë. Këto farë lloj raporte të auditimit funksionojnë sikur një farë lloj rëntgeni në tregun e neve gjenden se ku jemi na më tej na jep edhe diagnozën e sëmundjeve tona duke na dhënë rekomandimet të cilat i posedojna ne si komunitet. Andaj unë e inkurajoj edhe kisha të kërkojë prej qeverisë komunale prej kryetarit por pasi nuk është këtu prej teje nënkryetar mu marrë edhe me analizë dhe me shqyrtim mirë kësaj raporti të auditimit. Mu marrë me drejtorët që u takojnë dikastereve të tyre që iu udhëheqin ata në mënyrë që këto të gjetura mos mu na përsërit vit pas viti, mos mu na bëjë raporti i auditimit sikur ai raporti i progresit i bashkimit evropian prej 2006 e deri sot 60 % e përmbajtjes është e njëjtë që 20 vjet ka thanë i keq çito dhe ti s'ke mujt me ndreq asnjë. Andaj unë kur i lexova shumicën e këtyre të gjeturave një shumicë e madhe e tyre janë për shkak të neglizhencës jo që janë bërë me qëllim përfitimi ose korrupsioni. Thjeshtë është neglizhencë, andaj kisha të kërkojë që ju të angazhohi pak më shumë që ti eliminoni qitë farë lloj të gjetura ose defekte në këtë raport. Ajo që është pozitive në këtë raport unë e shoh faktin që këto raporte vit pas viti po vijnë drejtë përmirësimit. Raporti i këtij viti është më i mirë se raporti i vitit të kaluar dhe kjo na tregon neve që gjendja është duke u përmirësuar mirpo na vijnë një ritëm më i shpejtë i përmirësimit të gjendjes dhe për më përmirësim gjenden me një ritëm më të shpejtë duhet një angazhim dhe një punë pak më e madhe. Unë nuk du mu na me të gjeturat përveç kësaj që u përmend nga fillimi çështja e fotografimit të punësimeve partiake dhe kësaj punë të gjithë e dinë se është një fenomen që është instaluar prej luftës në Kosovë dhe më tej më tej krejt jemi pjesë e kësaj mentaliteti, dikush mundet me thanë mos na shtini krejtë me na thes por unë bash kishna pas qef me nxjerr dikund prej kësaj thesi por kërkoj nuk mu e nxjerri prej kësaj thesi. Tani kur flasim për punësimet politike: e para punës fakti që dikush është anëtar i një partie politike ose është aktivist. Unë jam anëtar i një partie politike por nëse është një vend qatje që unë i plotësoj kriteret atëherë çfarë shkelje bëhet nëse unë hi në punë. Është e vërtetë që e përmendi Albani se tre katër vetë janë njerëz të nismës ama ka edhe plot punësime tjera të cilët janë njerëz a politik ose të partive tjera të paktën po. Në vendin ku punoj unë në gjimnaz ka katër pesë profesorë që janë ardhë në punë prej 2013 e këtej e që nuk dojnë me qitë kryet me as një parti politike nuk është e nevojshme me emra por ti jap me shkrim nëse donë, ose prej fshatit tim p.sh ka punësime në shkollë prej anëtarëve të partisë demokratike partive tjera dhe njerëz apolitik. Nuk është çështja se këtu po punësohen veç njerëz të nismës por edhe të partive tjera. Na i dinë rrethanat në të cilat jetoj na bile unë i kisha ikuraju këta edhe krejt partitë tjera që brenda partive të tyre kanë boll njerëz të kualifikun ne ti qojnë çata por ku pi gjajnë çata me ka i gjysmë shkolle unë nuk e di ku pi gjajnë bash çata, keni njerëz të kualifikun secila parti të pregaditur kapni burrë qoni çata. Në qoftë se flitet këtu që nisma po punëson njerëz të vetë ajo nuk është e vërtetë ka plot njerëz dhe unë ti jap me emra plot njerëz që janë anëtar të subjekteve tjera që janë a politik e që kanë marrë vendet e tyre të punës që do të thotë kjo që është krejt normale se me bë na mi diskriminu qytetarët se të marrim se ti je me nismën mi than ti nuk bën me hi se ti nuk je i joni ti shko në shtyp. Ky është një shqetësim që funksionon te krejt partitë politike funksionon njëjtë nuk mundet me hëkë kërkoj. Edhe një fjalë edhe e kreu kryesues. Jam kanë ma i shkurtë prej krejt parafolësve. Kur doni merrme dhe bëne një analizë prej: 2000 – 2013 dhe prej 2013- 2017 kur ka pas më shumë punësime politike, në qoftë se tash dalin ma shumë se sa viteve të kalime, unë jam në gjendje me dal prej kësaj subjekti politik. Nuk ka shanca kur në të kaluarën kur ta ka bë vij të kuqe nuk

ke pasur shancë me hi në punë sot nuk ka vija të kuqe Alban nuk ka vija të kuqe. Tani gjendja është shumë ma mirë se sa ka qenë. Janë punësu njerëz të nismës por janë punësu edhe njerëz te subjekteve tjera politike që nuk ka ndodhur në të kaluarën.

Rrahim Morina: Nëse nuk e donë dikush fjalën kalojna në pikën tjetër shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë 01/954, dt: 04. 07.2019, e parashtruar nga kryetari i komunës lidhur me kërkesën numër: nr. 2683 dt. 01.07.2019 e parashtruar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Kullës së Sef Mleqanit në fshatin Mleqan KK. Malishevë.

Alban Mazreku: Paraprakisht ministria e ka kërku një lokacion për caktimin e ndërtimit të Kullës së Sefë Mleqanit, mirëpo kta nuk kanë mujtë mja gjetë dhe e kanë pru një kërkesë asamblesë komunale dhe për mos me qu ma gjatë grupi jonë e Përkrahë këtë kërkesë të ministrisë së Kulturës e cila drejtohet nga i nderuari Kujtim Gashi nga Partia Demokratike e Kosovës.

Sylë Dukolli: Po kryesues së pari na e përshëndesim aktivitetin artistik që e ka bërë Sefë Mleqani për neve si Llapushë dhe ti kthejmë argat ne që jemi pjesë e më vonshme e shoqërisë. Është e vërtetë që na bën nderë kulla e Sefë Mleqanit ashtu qysh na ka bë nderë Rapsodia e tijë ne kullat shqiptare. Ne e mbështesim.

Arlind Morina: Faleminderit kryesues edhe ne e mbështesim këtë iniciativë.

Alban Krasniqi: Kryesues ti e ki një shkresë që si KPF ja kemi adresu Drejtorisë së Kulturës nëse nuk gaboj është mirë me gjet dhe me thanë se masanej ne veç po bëhemi makinë ose votimi ose dalim folim këtu hajt pak kurgjë kerkujna. Për të ardhmen kur e jep një asamblistë një një propozim, e artikulon atë propozim duhet me qitë në votim, jam tujë fole për pikën paraprake e dhashë një propozim as që e përmende mendoj nashta që ke harru në rregull unë atë e qoj edhe vet përpara raportin e auditorit. Ti e qon ti ki drejt me qu kit lojën institucionale Sylë unë e kuptoj shumë mirë auditorët gjithashtu a janë qytetarë kur gjanë shkelje se krejt shkelje aty por ti si auditor je i obliguar me qu atë. Nuk u hedh në votim por në rregull në të ardhmen unë e qoj vetë edhe gjithmonë votoni kundër ato që i propozoj unë hiq mos t'ju ninë, veç a nihi mirë kur i votoni kundër se unë nuk i këqyri kush e propozon këto por e këqyri përmbajtjen e propozimit. E këtu nga një herë e kolegët e mi opozitar e këqyrin kush pe propozon hiqnu prej këtyre seneve se kjo është mentaliteti patriarkal e provincial. A e gjete kërkesën kryesues? Pra kërkesën që ne e kemi trajtu në KPF, kemi kërku kështu sqarime. Cili ka qenë deri më tani statusi i kësaj prone ku kërkohet rikonstruimi i kullës së lartcekur kërkohet informacion për rikonstruim apo kërkesë të kullës, ky objekt a parashihet të jetë pjesë e trashëgimisë kulturore të Ministrisë së Kulturës apo menagjimit të komunës të Malishevës apo e ndonjë personi fizik. Një komunë normale një asamblistë një përfaqësues ni qeverisje normale një kryetar normal një drejtor i Kulturës normal te funksionimit ish dashtë me i bë qito pyetje e mas anena të marr vendim. Na jo që, por me pare të shtetit jemi shumë zemërgjerë, janë pare e shtetit e para dhe e dyta edhe kontributi se edhe një shtatore nesër kur të ndërtohet me këqyr çdo sen. Një kullë kur e maron me këqyr statusi i sajë kush ka mu përkujdes apo me një kullë ku futen qentë edhe bahet kërdi brenda. Ma mirë është hiq mos me ba atë kullë se me pas një kullë nesër pa përkujdesje për ata këto përgjigje mi mbrojt me një vendimmarrje ma të letë e cila përgjigje neve nuk na ka ardhë. Kjo është mënyra qysh funksionojna na, ky është shteti ku na funksionojna ku është ministri i P.D.K-së e i LDK-së e i Nismës se këto janë hajgare mu marrë me ksi sene. Ndani me ministrinë këto sene partiake e masanej kini parasysh dëshmorët e as një partie nuk janë kanë. Veç qite ta kini parasysh kryetari i komunës është i komunës e as i një partie këtu me pas parasysh. Nuk janë dhanë këtu përgjigje duhet me përkrahë këtë iniciativë, përkrahjen me bërë në mënyrë cilësore e qysh i ka hije. Jo hajt se të bijtë e Sefes i kam ngu unë dy herë e hajt se e qoj dorën, urdhëroni sa hapësirë kena me ju nda a është e shkrume hapësira. Unë nuk po e shoh hapësirën. A është drejtori i kadastrit këtu me na tregu hapësirën çfarë vendimi se na kurrë e

marrim një vendim ngastra me kaq hapësirë. A është 70 hektarë a sa është 3 metra nuk e dimë pra qit informacion me kanë me na pru sa sa përfundu ajo edhe me ditë sa dajme se qysh dojna me ditë sa tokë po dajmë se ajo nuk është rikonstruim është ndërtim. Ndërtimi është ndërtim rikontruimi, rikonstruim, ndërtimi sipas modelit se qysh ka egzistuar kulla në qatë model qysh e kanë bërë, ama prona por sidomos se dojna me anashkalu si zakonisht kështu atëherë ta dimë sa tokë kena me da, unë nuk pe di sa tokë kena me da. Hajdin na jep qatë informacion ta dimë sa hapësirë e saktë për mu da për fillim, e këto tjerat nëse jini të interesun me ditë përgjigjen, unë jam i intersun me ditë a e mbikëqyr komuna a e mbikëqyr ministria apo kujt i jetë në mbikëqyrje dhe mu kujdesë për të.

Kastriot Berisha: Alban po ta përmendi emrin se ju të vetëvendosjes nuk jini msu hala me ministra sikur këta të PDK-së, nuk keni pa nuk ju ka rasti me ja ni lezetin se i përmendni edhe ju. Edhe na kryesues e përkrahemi edhe pse parafolësit po folin fjalë të mëdhaja por megjithatë është mirë.

Rrahim Morina: Para se me fol Arbëresha është mirë mu ditë sipërfaqja se sa vend është.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues faleminderit është mirë që po bëhet një punë e tillë dhe kërkush nuk është kundër edhe i gëzohemi këtyre investimeve e veçanërisht të vlerave tona historike. Me të vërtetë unë pajtoj me atë se përnime duhet me pas një shkrim edhe pavarësisht prej kujt vjen duhet me pas një sqarim. Na e patëm edhe piken tjetër për sqarim pishinën gjysmë olimpikë përnime është qikjo çështje kështu që unë prej nivelit nga radhët e asambleistës së nismës përkushtim më të madh të personave gjegjë, por dhe japë vërejtje njëkohësisht. Mendimi imë është që të votohet më tutje të jepen të gjitha informacionet është me rendësi edhe pyetja se në menagjim të kujtë është. Mue ma merr mendja thamë prapë me atë skepticizmin tim, mirëpo besoj që është nën menagjimin e komunës, por megjithatë ne duhet me ditë edhe kini drejt me ditë dhe me kërkush saktë se kush do ta mbikëqyr këtë ndërtim. Para së gjithash parimisht jam për me mbështetë është mirë me votu pa dallim të gjithë ne dhe sigurisht mi pasur të kjo të gjitha ato pyetje dhe informacione që janë në interes tonin por edhe na pajisin neve me këto vlera krahas projekteve të cilat po ndërtohen.

Rrahim Morina: Faleminderit Arbëreshë por me mujtë me kriju një kulturë që unë ju kemi drejtu kryetarit me shpresë ju kemi drejtu, kjo punë i ka mbi dhjetë ditë. Ju lutem është mirë mu mësu në këto çështje me marrë përgjigje në do sene se është mirë mu ditë sipërfaqja kush do ta mbikëqyr se kjo nuk kërkon edhe ndonjë punë dhe munda të madhe me thirrë ministrinë mu marrë vesh. Por si do që të jetë Ilaz urdhëroni e kini fjalën.

Ilaz Krasniqi: Edhe ne duhet ta përkrahim këtë projekt dhe të plotësohet se qysh është më së miri, por kur të jemi të vlerat këtu edhe kërkesat tash këtu po shihet se nga kush po vinë deshta me ju pyet si anëtarë të kuvendit shoqatat e dalura nga lufta dhe unë nuk do ti hiqem kësaj ka qenë prej 5 ari të tri organizatave nga lufta. Cilit ministër duhet me ju drejtu që me pru një propozim për me da një lokacion për veprimtarinë e saj për me pas një vend? Besoni po më vjenë keq shumë herë kamë kërkush dhe tri organizatat e dalura nga lufta fort nuk e di nuk ju ka bërë përshtypje ose për shka mu kanë dikush ministër me pru kërkesën ktu, por jo një komitet që e përfaqëson këtë kategori se di tash a munda ta quaj që edhe kjo është vlerë organizatat e dalura nga lufta a janë vlerë dhe a nuk janë vlerë shumë sinqerisht. Unë jam për me përkrahë projektin absolutisht.

Rrahim Morina: Ju lutemi shkojna në votim ne po votojna që mjetet ti ndajnë dhe ti nisin për Malishevë e për çështje tjera tani, kush është për ju lutem me ngritje të dorës:

Nga 20 të pranishëm unanimisht ishin të gjithë. Ju lutem pjesa e sipërfaqes edhe kush do ta mbikëqyrë votojna në një mbledhje në të ardhmen ju lutem çështjen e Panorcit se qe 15 herë që po vjenë dhe cili do qëndrim ne do ta marrim një qëndrim se për shka se unë po tregoj se qe dy tri herë kryetari me insistimin e tij unë e kamë shti në rend të ditës sepse ai po thotë pse pe pengon ti le ta kthen kuvendi.

Prandaj është mirë që ta marrim një qëndrim rreth kësaj pike unë e hapi debat, ndashi ju japim vetëm shefave të grupeve. Në nivel të shefave të grupeve.

Sylë Dukolli: Për këtë pikë kamë fole edhe më herët u bë si u bë unë jam për me ju dhanë shtytje, projekti atje është tujë vazhdu, puna është tujë u krye ajo ana e pjesës kontestimore që ju e kini ngritë si opozitë hiq problem nuk është. Në të merret ana gjygjësore kush i ka ngrit ato çështje apsolutikisht nuk jam kundra, mirëpo unë mendoj që është mirë mi dhanë version final në atë kuptimin që këtë pikë ta qojna përpara. Jemi që të votohet propozimi i kryetarit për pikën e Panorcit që tash më për herë të pestë vjen në asamble ose për herë të shtatë. Para së gjithash është shkollë është interes i nxënësve i fëmijëve kanë mujt mu bë lëshimet rrugës i kuptojna se na nuk jemi që nuk i dina do gjëra. Mendoj që i ka ardhë koha që ta kemi një marrëveshje të përbashkët dhe ta krymë si proces. Na nisma jemi për.

Alban Mazreku: Ka qenë kërkesë e kahe motshme e kryetarit të komunës si dhe e grupit parlamentar të nismës që kjo pikë bile të paktën të jetë në rend të ditës. Kryesues ne si grup e kemi theksu qysh edhe më herët se kjo si lëndë për mos respektim të procedurave është tash në hetuesi në Prishtinë. Atëherë na si grup parlamentar e deklarojna votën publikisht kundër iniciativës së kësaj pike të kryetarit për arsye se është nën hetime. Në procesverbal komplet grupi i Partisë Demokratike ka me votu kundër inicimit edhe me marrë një vendim që kjo pikë mos me na ardhë më në asamblenë komunale deri sa të vjenë një vendim i gjygjësorit të shtetit të Kosovës.

Arind Morina: Ne si grup parlamentar e përkrahëm kërkesën e Alban Mazrekut që e ceki që jena kundër kësaj.

Alban Krasniqi: Shihet që është çaq i zoti aj ministri që e përmendi njani prej parafolësve më herët dhe që ka guxim le të shkon le ta maron atë objektin aty ku në parim vendosëm. Pra nuk mun me shku kërkush me ndërtu kerkund pa vendim të Kuvendit Komunal këtu ishte esenca edhe kjo i bjen se një standard e përdorëm më herët natyrshëm, i bjen që atë standard ish dashtë me respektu edhe Kryetari. Nuk e ka respektu edhe ne e kemi gjet në shkelje kryetarin në këtë drejtim nuk e ka ndalu kërkush me pru me kohë, nuk e ka sjellë. Ne ta bjen vendimin gjykata për mue është shume mirë që shkolla është tujë u ndërtu ndonëse dyshoj a ka mu mush najë herë ajo shkollë urojë që mu mushë e mos mi dal fshatit ajo shkollë por realiteti është krejt i ndryshëm. Për qata ma mirë a kanë mu investu më ndryshe aty edhe që parja mos me na shku si me thanë dëm në beton por me na shku në njerëz të cilët kishin mujtë me punu e me mja bë jetën me të mirë por kjo çështje e vendimmarrjes. Tash na jemi para një akti ku duhet mu kanë sy qelë, mos me ra në najë farë gracke, mos me ra në shkelje të rëndë ligjore, mos me bë të gjithë ne objekt i policisë e mos me na thirrë rëndë se pse votove ti kështu e pse ashtu. Na për qata nuk kemi dashtë me fut jo pse është çështje votimi ose mos votimi ta kemi parasysh se është punë e qartë se ka mujtë mu mbuivotu por tujë e pa që nuk po nali po e sillni. Ta krymë na ni herë kit punë ta refuzojmë ashtu qysh na takon me refuzu edhe ta lajna qysh e tha edhe Albani në këtë rast që ta shtyjmë ose mos ta pranojmë diskutimin e kësaj dhe ta refuzojmë për këtë ndarje të tokës kompensim çka do qysh e kanë përceptu aty edhe kanë shkru që duhet të ndodhë deri në një vendim prej organeve gjygjësore. Kur organet gjygjësore marrin një vendim të shkallës së caktime edhe ne kena me marrë një vendim si të kryhet ajo dhe keqas me kry obligimin në këtë rast ndajë qytetarit për pronën e cila në këtë rast është prej komunës që ju është uzorpu. Është një rast i kundërt ligjërisht është kështu por deri sa të sqarohet kjo punë na nuk besoj që kemi të drejtën edhe me marrë vendim se bajna edhe na shkelje. Bile shkelje edhe me marrë vendim edhe për kundër hiq mos me dashtë me trajtu por meqenëse deri qitu ka ardhë puna atëherë ta kryna. Unë jam me kushtin që mos me sjellë kryetari hiq mos me marrë vendim me lënë deri sa të kryhet, kur të kryhet si të vjen një vendim i gjykatës që në rregull është diçka çka po di mujna me ardhë me një vendim edhe na por jo në këtë rrethanë qashtu qysh jemi. Qysh doni e votojmë por nëse shtyhet le të shtyhet edhe mos të vjen ma pa u marrë vendimi prej gjygjësorit qysh doni.

Kastriot Berisha: Kjo Nisma kjo që është edhe është mirë që me pa pak a shumë vetën se e huptë një rast sallën e sportit në Drenoc tash ja kini nisë me ato olimpiadat mi qu në banjë, d.m.th mi shkelë rregullat për kit arsye funksionon edhe gjykata edhe ne si grup parlamentar d.m.th kërkojna që kjo pikë të mos vjen ma se a bë bajat se i ka hupë edhe vlera i ka hupë deri sa të vjen një vendim i gjykatës. Sylë është mirë me nejtë me votu këtë qysh kini ditë me qu ju faleminderit.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues nuk ka faj se është çështje shqetësuese nga një herë me dalë me fol me ju kallzu qytetarëve e jona legjitime por përnime me fol dikush për shkollat është përnime shumë problem. Kështu që duhet me mendu fort edhe me dëshmu individualisht aj që del dhe fol për procesin mësimorë e për avancimin e shkollave dhe ndërtimin e objekteve dhe tani përnime mendojnë që është qashtu. Ajo që e tha Albani në një dilemë mes asaj që nëse është në organet e drejtësisë dhe ne po marrim një vendim përnime nga një herë është kontradiktore me atë që bëjmë thirrje vazhdueshëm. Kërkesa e kryetarit për sqarimin tuaj i nderuar kryesues dhe të gjithë ju kolegë asamblastë: kërkesa e kryetarit ka qenë kjo duke u bazuar në marrëveshjen verbale që ka pas me titullarin e pronës private, kryetari i komunës e ka fillu edhe procesin e punimeve kjo është e gjitha. Në anën tjetër çka do të ndodhë me titullarin e pronës private unë nuk e di çka do të thotë aj unë nuk e di. Unë e di njerëzishëm që aj ka një marrëveshje verbale me atë person. A ka deviju aj gjatë rrugëtimit prapë nuk e di. A është i njëjti prej fillimit unë nuk e di, kjo është ideja ka shku në organet e hetuesisë në rregull që ka shku e jep verdiktin e drejta ligjore krejt okej është për mue, ama mos të ngutemi ne. Unë konsideroj mendim i imi personal jo i grupit që edhe kryetari Begaj ndoshta në një dozë nervoziteti për këtë çështje edhe ka insistu vazhdueshëm me pru në kuvend për mu trajtu por ideja ka qenë që mos të dalim ne si grupe politike kundër ndërtimit të shkollave në Malishevë. Mos ta bastardojmë këtë kështu që ndoshta për mendimin tim do të ishte shumë më në rregull që edhe të mos trajtohet të mbetet kusht si është. Unë e di që grupi jonë parlamentarë Alban është për. Na kena me votu për mu ndërtu ajo shkollë. Punimet kanë fillu aty por megjithatë unë konsideroj që mos po bjenë ndeshë me atë që është në proces vetë kjo lëndë. Është e inicime prej opozitës gjithçka është në rregull ashtu kanë mendu ashtu ka shku procesi, por nuk është mirë mi dhënë ne konotacion asaj që ne po thirremi gjoja se në të drejta në anën tjetër po pengojmë një infrastrukturë shkollore arsimore për ata nxënës dhe mësimdhënës që janë aty edhe po ja mohojna të drejtën. Unë e di që janë paret tonat tek ma e fundit ke apo nuk ke investim ose i nivelit lokal ose i atij qendrorë. Ne të gjithë jemi qytetar të kësaj republike dhe i gëzohemi të gjitha investimeve ama mos të ngutemi unë konsideroj. Grupi jone është për që kjo shkollë të vazhdon punën dhe të kryhet me sukses. Inshalla donë zoti edhe ato nëse ka pakënaqësi të sqarohen. Unë e di që kryetari Begaj nuk e ka bë për as një qëllim tjetër as të përfitimit e as të dëmtimit të as një pale. E di që e ka bërë ne interes të nxënësve dhe mësimdhënësve atje është mirë të gjithë me pa qishtu.

Rrahim Morina: Unë kamë qenë pjesë e bisedimit të kësaj çështje po dëgjoj disa fjale ashtu kështu. Unë do ta tregoj origjinal se si ka qenë kjo çështje më ka ftu kryetari Begaj jam shku aty ka qenë Muharremi ka qenë prezentë edhe pronari por ishte pronë e katër pesë vëllezërve nëse nuk gaboj Bilalli ka qenë prezent aty. Edhe unë e kam sqaru mënyrën dhe procedurën e këmbimit të pronës por incizime nuk ka sigurisht mundet me thanë dikush ashtu ose kështu por shyqyr zotit nuk jemi kanë vetë. Unë kamë thënë Kuvendi bënë vetëm këmbimin e pronës. Vlerësimin e bënë ministria dhe pastaj kuvendi vendos për këmbimin e pronës me kërkesë të kryetarit. Ata kanë pas problem që prona ku është ndërtu shkolla prej 8 ari që ja ka marrë komuna aj vllau i tije kishte qenë në Zvicër dhe me kohë nuk e kishte dorëzu letërnjoftimin tre katër muaj dhe kryetari ka fillu. Ktu po flitet jo për shkollë por për shkelje procedurale për këmbimin e pronës me bë tenderimin e pastaj me vu gurthemelin. D.m.th këtu çdo gjë ka vazhdu dhe kryetari nuk ka pritë letërnjoftimin e pronarit që ka qenë në Zvicër me pru dhe na me votu. Mirëpo kryetari i ka shkelë ato procedurat tjera paraprake. E ka shpallë tenderin e ka bë gurthemelin e tani pastaj po kërkon kjo kërkesë e tina mu realizu edhe kuvendi me bë këmbimin pas

këtyre shkeljeve ligjore. Tri grupet parlamentare kanë marrë iniciativë që për shkak të shkeljeve ligjore dhe këtë çështje e kanë qu në gjykatë dhe e tëra është një çudi që ka shku qishtu.

Hajdin Berisha: Faleminderit Kryesues nuk e di mundë të gaboj por nashta është hera e shtatë që është kjo pikë në rend të ditës edhe në takimin në seancën e kalume kamë kërku decidivisht që pse nuk lihet në rend të ditës dhe të diskutohet edhe të vina bashkërisht te një konkluzion dhe ti diskutojna arsyet të cilat kanë sjellë deri këtu. Mirëpo sot kryesuesi u tregu zemërgjerë e la në rend dite dhe krejt ne periferi në përfundim të mbledhjes kur gjysma e asambleistave veçë filluten me u qu edhe e hapi debatin lidhur me një pikë që konsideroj është jashtëzakonisht e rëndësishme. Dallojnë deklaratimet prej asaj që kemi vullnet me ndërtu një shkollë edhe veprimeve, krejt tek kjo ka ardhe si rezultat pa asnjë diçka negative që mundet me pas ose me qëllim të përfitimit të kryetarit në nisjen e shkollës në Panorc por qysh janë zhagu procedurat pak a shumë e tha edhe kryesuesi por që apsolutishtë e konsideroj që kryetari është shumë i pastër në këtë drejtim. Kanë ngeçë procedurat nuk janë kry tash qysh po neglizhohen nuk po kryhen. Kryetari është këtu nuk e ka ndërmendë me leshu Kosovën cilës do dyshim për shkelje ligjore dhe shkelje proceduarve ne jemi këtu dhe kemi me ju përgjigj. Ama shkolla duhet mu vazhdu mandej kur ta kemi një verdikt të gjykatës qysh po thoni ju ndoshta kemi me u ndi keq që nuk e kemi kryq që në fillim.

Alban Mazreku: Nuk është mirë mi dhanë konotacion kërkush në atë aspektin politik se dikush një grup është për shkollën e dikush është kundër shkollës. Kjo nuk qëndron dhe as grupi parlamentar i PDK-së, as te grupet tjera as i Nismës, as i Vetëvendosjes, as i LDK-së, as i AAK-së. Por si procedurë na vet e kemi ndjek se na e dina sa kemi pasur problem te rregullimi i shtratit të lumit Mirusha. Paraprakisht na e kemi marrë një vendim për shpallje të zonës në interes publik. Edhe shkolla është në interes publik nuk është as për Albanin as Arbëreshën por është për qata fëmijë të çasaj zonës së Panorcit. Realisht a shpallë zonë e interesit ministria është dale ne teren e ka bë vlerësimin e pronës, në bazë të vlerësimit të pronës edhe e ka bë zhvlerësimin dhe kompensimin e pronës të atyre banorëve. Këtu nëse kryesuesi ka bë marrëveshje verbale qysh e tha Arbëresha, kjo është shumë shumë gabim edhe për kryesuesin. Se marrëveshje verbale nuk ka marrëveshja duhet mu kanë e shkrume nëse bahet marrëveshja duhet mu kanë e shkrume. Mju potencu që nuk është kërkush kundër shkollës është kundër procedurës që e kanë ndjekë. Çka do me thanë nesër po ndërtohet shkolla aty thotë ma ka ndertu kuvendi komunal në prone teme kërkon ndoshta dëmshpërblim nj milion euro komuna e jonë është e varfre nuk i ka ato. Interes publik janë të dyja, nuk është kërkush kundër shkollës.

Rrahim Morina: Faleminderit Alban por kryesuesi nuk ka bë kurrfarë marrëveshje verbale. Vetëm që aj pronari e ka kërku edhe raportin dy me një, i thashë kush është aj që ta jep. Nëse kryetari donë me ta dhanë kuvendi është aj që bënë vetëm këmbimin e pronës vlerësimin e bënë tjetër kush. As vlerësimin aj nuk e bënë, e bënë ministria e tëra ka qenë kështu. Shkojna në votim. Një kërkesë e Arbëreshës që mos të hedhet në votim kërkesa e kryetarit, ani po e hedhim kërkesën e Alban Mazrekut që kjo pjesë e rendit të ditës mos të na vjenë në kuvendë deri sa të vjenë një verdikt përfundimtarë i gjykatës: kush është për?

Për 14, kundër 1, abstenim 4. D.m.th aprovohet kërkesa.

Me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 16:00.

Procesmbajtësi: Ilir Kryeziu

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina